

1 E martë, 14 mars 2022

2 [Deklaratat përmbyllëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 9.30 paradite

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes
7 dhe mirë se erdhët, të gjithë.

8 Zonja Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqitni lëndën.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Kjo është çështja KSC-
10 BC-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe
11 Nasim Haradinajt.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
13 Paraqitjet e palëve.

14 Zonja Bolici.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.

16 Për ZPS-në paraqiten zoti Alex Whiting, Zëvendësprokuror
17 i Specializuar; Matthew Halling, Prokuror; zoti James Pace,
18 Ndhmësprokuror; Line Pedersen, Menaxhere e Çështjes dhe e
19 Provave; Marie-Cecilia Grudzinski, stazhiere; dhe unë jam
20 Valeria Bolici, Prokurore.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 zonja Bolici.

23 Zoti Rees.

24 Z. REES: [Përkthim] Unë përfaqësoj zotin Gucati. Dhe kam
25 këtu zotin Huw Bowden dhe zonjushën Faye Wigmore.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë përfaqësoj zotin Haradinaj. Dhe
3 këtu kam së bashku zoti Worboys, zotin Frivet dhe zotin
4 Berisha.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe zoti
6 Haradinaj dhe zoti Gucati janë në sallën e gjyqit.

7 Sot fillojmë me deklaratat mbyllëse në çështjen Prokurori
8 kundër zotit Gucati dhe Haradinaj.

9 Siç u tha në urdhrin e Panelit të datës 3 shkurt, do të
10 bëhen paraqitjet e deklaratave mbyllëse si më poshtë.

11 Më 14 mars, do të bëhet deklarata mbyllëse e Prokurorit
12 të Specializuar dhe pyetje nga Paneli.

13 Prokurori nuk duhet të marrë më shumë sesa dy seanca dhe
14 30-45 minutat e fundit duhet t'ia lërë Panelit për pyetje.

15 Më 15 dhe 16 mars, do të dëgjojmë deklaratat përmbyllëse
16 të Mbrojtjes së Gucatit dhe të Haradinajt dhe do të ketë
17 pyetje nga Paneli.

18 Këto deklarata nuk duhet të trajtojnë çështjen e dhënies
19 së dënimit.

20 Mbrojtja duhet të marrë parasysh se pyetjet e Panelit do
21 të zgjasin 30-45 minuta mbas çdo deklarate dhe duhet ta
22 mbarojnë deklaratën e tyre 45 minuta para sesa të mbarojë koha
23 e tyre.

24 Zoti Rees, a mund të na informoni si e keni ndarë kohën
25 midis jush.

1 Z. REES: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë mendoj që do
2 të vazhdoj deri të mërkurën. Dhe e diskutova këtë me zotin
3 Cadman dhe do të ketë shumë kohë zoti Cadman që të bëjë
4 deklaratën e tij përmbyllëse.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më 17 mars,
6 Paneli do të dëgjojë përgjigjen e Prokurorit të Specializuar
7 dhe pyetje nga Paneli.

8 Më 17 mars, në seancën e dytë, Paneli do të dëgjojë
9 parashtrime në kundërpërgjigje të përgjigjes së Prokurorisë
10 nga Mbrojtja e Gucatit dhe e Haradinajt.

11 Dhe në të njëjtën ditë, në seancën e tretë, Prokuroria do
12 të bëjë parashtrime për dhënien e dënimit e për ndonjë provë
13 shtesë dhe informacione që do të nxirren sot. Paneli mund të
14 bëjë pyetje.

15 Më 18 mars, seanca e parë dhe e dytë, Paneli do të
16 dëgjojë parashtrime të Mbrojtjes së Gucatit dhe të Haradinajt
17 në lidhje me dhënien e dënimit dhe sidomos, parashtrime për
18 provat materiale që do të nxirren sot dhe ndonjë informacion
19 që do të nxirret sot.

20 Dhe, në fund, më 18 mars, në seancën e tretë, Paneli do
21 të bëjë pyetjet e fundit që ka për palët dhe do të dëgjojë
22 deklaratat e të akuzuarve; 30 minuta secili.

23 Paneli do të përpiqet të bëjë pyetje në fund të secilës
24 deklaratë të palëve. Megjithatë, në qoftë se do të jetë nevoja
25 Paneli do të bëjë pyetje edhe gjatë parashtrimeve me gojë. Kur

1 mbarojë ndonjë seancë më para se sa është planifikuar, Paneli
2 do t'u kërkojë palëve që të vazhdojnë përpara sesa është
3 parashikuar.

4 Paneli i kujton palët se në bazë të rregullit 135(2) të
5 Rregullores, deklaratat mbyllëse mund t'i referohen provave të
6 pranuar dhe besueshmërisë së tyre. Besueshmërisë,
7 mbështetshmërisë së dëshmitarëve.

8 Materialet ilustrative dhe përmbledhjet e provave, në
9 qoftë se janë të bazuara në dëshmi dhe në provat e dhëna, mund
10 të përdoren.

11 Paneli i kujton palët që duhet të mos përsërisin gjërat
12 që janë përmendur në dosjet përfundimtare të palëve.

13 Deklaratat politike, referencat ndaj krimeve që janë
14 kryer në Kosovë gjatë konfliktit apo drejtësisë së luftës,
15 duhet të shmangen. Palëve u kujtohen gjithashtu që të mos të
16 përmendin informacione konfidenciale në seanca publike.

17 Zonja Bolici, keni ju fjalën.

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

19 Në fund të gjykimit të zotit Gucati dhe zotit Haradinaj,
20 unë dua të kujtoj se kjo çështje është shumë tipike por është
21 dhe shumë unike. Është shumë tipike sepse sjelljet e
22 frikësimit të dëshmitarëve dhe pengimit të drejtësisë kanë
23 ndikuar në hetimet dhe në gjykimet ndaj anëtarëve të UÇK-së
24 për 20 vjet.

25 Kjo çështje është shumë unike sepse ata që janë

1 përgjegjës për frikësimin dhe pengimin e procedurave janë
2 sjellë që të japin llogari përpara një gjykate të drejtësisë.
3 Dhe po kështu edhe sepse provat kundër të akuzuarit janë shumë
4 bindëse, janë jashtëzakonisht bindëse.

5 Që në fillim të këtij gjykimi, Zyra e Prokurorit të
6 Specializuar ka treguar në këtë Gjykatë se sjellja kriminale e
7 të akuzuarve është e incizuar në një numër videosh që janë
8 transmetuar publikisht. Në këto prova audiovizuale, të
9 akuzuarit shikohen kur kryejnë sjelljet kriminale të cilat
10 pretendohen në Aktakuzë. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj
11 gjithashtu shihen dhe dëgjohen duke e shprehur me fjalë
12 qëllimin e tyre kriminal në mënyrë të hapur, në mënyrë të
13 ashpër dhe të përsëritur.

14 Në fund të këtij gjykimi, ne jemi këtu për të pranuar se
15 sjellja e të akuzuarve mbetet e pakundërshtuar. Mbetet e
16 pakundërshtuar që Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj kanë bërë
17 tre konferenca shtypi më 7, 16 dhe 22 shtator 2020. Nuk është
18 kundërshtuar që ata kanë shpallur se kishin në posedim
19 dokumente konfidenciale që i përkisnin TFHS-së dhe ZPS-së dhe
20 hetimeve të tyre, që përmbanin emra dhe të dhënat personale të
21 dëshmitarëve të mbrojtur. Si dhe nuk kundërshtohet se ata kanë
22 shpallur se i kanë dhënë këto informacione konfidenciale atyre
23 që ishin të pranishëm dhe të gjithë publikut. Është e incizuar
24 se ndërkohë që ata i shpërndanë këto materiale konfidenciale,
25 përfshirë edhe emrat e dëshmitarëve, ata e pranuan se këto

1 ishin të ndaluara të bëheshin me ligj. Është e incizuar se ata
2 iu drejtuan dëshmitarëve ose i quajtën dëshmitarët dhe ata që
3 bashkëpunuan me këtë Gjykatë si tradhtarë, gënjeshtarë, spiunë
4 dhe bashkëpunëtorë; dhe ata thanë që këta dëshmitarë nuk mund
5 të mbroheshin më. Në 15 paraqitje publike dhe në deklarata,
6 këta të akuzuar kanë pranuar se ata po i kryenin këto veprime
7 në mënyrë që të shpërndanin këtë Gjykatë, që të zhbëhej kjo
8 Gjykatë.

9 Dhe kjo është vetëm pika e fillimit e provave që ka ky
10 Trup Gjykues para vetes.

11 Pjesa e tjetër e provave që janë paraqitur në Gjykatë
12 plotësojnë dhe vulosin provën për përgjegjësinë e të akuzuarve
13 për të gjitha krimet në Aktakuzë përtej dyshimit të arsyeshëm.
14 Prova shtesë erdhën jo vetëm nga dëshmitarët e paraqitur nga
15 ZPS-ja, por pa pritur edhe në mënyrë shumë domethënëse edhe
16 nga dëshmitarët që paraqiti Mbrojtja. Sa herë që dëshmitarët e
17 Mbrojtjes u përballën me faktet që lidheshin me akuzat, ata
18 nxorën prova inkriminuese, një pas tjetrit, duke filluar edhe
19 nga vetë të akuzuarit.

20 Në dosjen paraprake, në deklaratën hyrëse dhe gjatë
21 dhënies së dëshmive të dëshmitarëve dhe në dosjen
22 përfundimtare të vetën, ZPS-ja i ka hyrë thellë fakteve mbi të
23 cilat bazohen akuzat. Mbrojtja, nga ana tjetër, u përpoq që
24 t'i largohej fakteve të kësaj çështjeje gjatë të gjithë
25 procedurave gjyqësore. Dhe kjo është sepse provat janë kaq

1 domethënëse dhe inkriminuese dhe në mënyrë që të argumentonin
2 se të akuzuarit nuk janë fajtorë sipas akuzave, Mbrojtja duhet
3 t'i injoronte faktet dhe të mos i merrte parasysh provat edhe
4 provat e veta.

5 Kështu që Mbrojtja mbetet të argumentojë se të akuzuarit
6 i kryen aksionet ose veprimet e akuzuara në Aktakuzë, por se
7 veprimet e tyre, sjellja e tyre nuk penalizohet sipas Kodit
8 Penal të Kosovës. Mbrojtja përpiqet ta bëjë këtë duke
9 shtrembëruar kuadrin ligjor. Ata përpiqen të gjymtojnë
10 fushëveprimin e dispozitave penale në një mënyrë të tillë që,
11 në qoftë se pranohen, këto shkeljet më të rënda sjelljet e
12 frikësimit, të hakmarrjes dhe të pengimit të procedurave
13 penale, nuk mund të dënohen sipas ligjit të Kosovës, përfshirë
14 edhe nga kjo Gjykatë.

15 Prokuroria parashton me respekt që në qoftë se faktet e
16 kësaj çështjeje nuk injorohen dhe në qoftë se nuk
17 keqinterpretohet ligji i zbatueshëm, do të pranohet
18 përgjegjësia penale e këtyre të akuzuarve si shumë e qartë.

19 Mbrojtja e di shumë mirë këtë. Dhe prandaj argumenton se
20 të akuzuarit, megjithatë, duhet të shfajësohen nga
21 përgjegjësia penale bazuar mbi një numër mbrojtjesh të sajuaara
22 të cilat nuk bazohen në dispozita të shëndosha.

23 Gjatë të gjithë gjykimit, të akuzuarit u përpoqën që ta
24 paraqisnin veten si përfaqësuesit, flamurtarët e një drejtësie
25 të lartë - një version modern i Antigonës. Ata thonë se nuk

1 duhet të ndëshkohen, sepse duke shkelur ligjin, ata ndoqën
2 synimet e drejtësisë që i kanë përkufizuar ata vetë. Ne këtu
3 nuk do të përfshihemi në thënie se pse ligji për mbrojtjen e
4 sekretit të hetimeve, privatësisë, sigurisë, dinjitetit dhe
5 mirëqenies së dëshmitarëve janë të domosdoshme dhe të drejta.
6 Ne, gjithashtu, nuk do të diskutojmë këtu nëse të akuzuarit,
7 në fakt, u përpoqën të ndjekin interesat apo të zbatojnë
8 interesat e një grupi individësh kundër interesave të
9 shoqërisë të cilat bazohen në ligj. Ne, megjithatë, do themi,
10 pa hezitim, se të akuzuarit nuk janë mbi ligjin. Veprimet e
11 tyre të përsëritura dhe të qëllimshme e kanë shkelur Kodin
12 Penal të Kosovës dhe nuk justifikohen nga dispozita të tjera
13 penale. Të akuzuarit janë kriminelë.

14 Në deklaratën mbyllëse të sotme, ZPS-ja do të thotë se
15 ZPS-ja ka paraqitur prova të cilat provojnë fajësinë e tyre
16 ose përgjegjësinë e tyre përtej dyshimit të arsyeshëm. Unë, në
17 pjesën e parë, do të flas për faktet të cilat përfshihen në
18 Aktakuzë. Ndërsa, në pjesën e dytë, zoti Halling do të
19 trajtojë përgjigjet tonë për çështjet e ndryshme që ka ngritur
20 Mbrojtja në dosjet e tyre.

21 Të enjten, sipas programit që përcaktoi Trupi Gjykses,
22 Prokurori do të mbajë një fjalë hyrëse në lidhje me dënimin e
23 kërkuar dhe zoti Pace do të flasë për çështje të tjera që
24 lidhen me dënimin dhe përgjigje ndaj argumenteve të Mbrojtjes.

25 Së pari, do të filloj me shkeljen e sekretit të

1 procedurave.

2 Dhe do të them duke deklaruar atë që është e dukshme dhe
3 e qartë, se të dy të akuzuarit kanë argumentuar vazhdimisht të
4 kundërtën gjatë këtij gjykimi. Unë do të luaj një pjesë në
5 video të zotit Gucati dhe pastaj do të flas për pozicionin e
6 të akuzuarit. Kjo pjesë do të luhet në anglisht.

7 [Luhet videoincizimi]

8 PËRKTHYESI: "Së pari më vjen keq kur thoni i shpërndarë.
9 Ne s'kemi shpërnda asgjë. Ne i kemi lënë në tavolinë. I kemi
10 thënë fotografoni, e para.

11 "E dyta, i kemi tërhequr vëmendjen të gjitha mediave,
12 emrat s'guxon të publikohen dhe deklaratat s'guxohen të
13 lexohen. Kjo ka qenë dhe qëndroj prapa saj tërë jetës time që
14 të ruhet gjithmonë privatësia e çdo qytetari pavarësisht se
15 kush është, a është serb, a është shqiptar, a është turk, romë
16 apo ashkali, se në Kosovë kemi shumë kombe që jetojnë kështu
17 që i përmenda të gjithë".

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Zoti Gucati, ngriti dy çështje në
19 këtë pjesë të shkurtër që u luajt këtu dhe në fakt, të dy të
20 akuzuarit e kanë theksuar këtë gjatë dëshmive të tyre. Së
21 pari, ata thanë që ne kemi shpërndarë dokumente, vetëm ne i
22 vendosëm ato në tavolinë. Dhe së dyti ata thanë që ne i thamë
23 atyre të pranishmëve në konferencën e shtypit që mos t'i
24 shpërndanin ato.

25 Çështja e parë. Që të dy të akuzuarit e pranojnë se ata

1 sollën kopje të shumëfishta, me mijëra faqe, në konferencat e
2 shtypit të parë, të dytë dhe të tretë; dhe se e dyta, po, ata
3 i ftuan personat që ishin të pranishëm që të merrnin sa
4 dokumente të donin; dhe, po, kështu që, ata të pranishëm
5 faktikisht morën kopje të shumta të këtyre dokumenteve.

6 Megjithatë të akuzuarit thonë, se ata nuk mund të dënohen
7 për shpërndarjen e dokumenteve konfidenciale në këto
8 konferenca shtypi, sepse ata nuk u dhanë në dorë dokumente
9 njerëzve. Dhe kjo, mendojnë ata, ka zbuluar një boshllëk në
10 Kodin Penal dhe ata nuk mund të dënohen në bazë të Kodit
11 Penal.

12 Por argumentet e tyre janë të paqëndrueshme.

13 Sjellja e kopjeve të shumta të dokumenteve konfidenciale
14 për personat që ishin aty që t'i lexonin ato, të bënin
15 fotografi dhe t'i merrnin me vete është një mënyrë për të
16 nxjerrë informacion konfidencial sipas kuptimit të nenit
17 392(1) dhe (2) të Kodit Penal.

18 Siç thuhet në vendimin e konfirmimit, kodi nuk e kufizon
19 mënyrën se si shpërndahen materialet apo si nuk bëhen të
20 ditura materialet. Ato mund të bëhen përmes tregimit,
21 transmetimit, e tjerë, citimit, referimit të përmbajtjes, e
22 tjerë. Të akuzuarit shpresojnë që të fshihen mbas asaj që nuk
23 janë dhënë, nuk janë dorëzuar në dorë të personave të
24 pranishëm këto dokumente.

25 Provat në këtë çështje provojnë përtej dyshimit të

1 arsyeshëm se të akuzuarit kanë zbuluar informacion
2 konfidencial duke shpërndarë dokumentet në konferencat e
3 shtypit, por edhe në rrjetet sociale. Po kështu të akuzuarit i
4 shpërndanë ato më tej pasi ishin botuar nga mediat.

5 Të akuzuarit nuk e mohojnë se ata kanë thënë që këto
6 veprime kanë ndodhur. Të akuzuarit thonë që këto veprime nuk
7 përmbushin kushtin e *actus reus* sipas nenit 392(1) dhe (2).

8 Çështja e dytë. Të akuzuarit thonë se ata nuk janë
9 përgjegjës penalisht sepse ata thanë, në kohë të caktuara, që
10 emrat e dëshmitarëve nuk duhet të botohen, nuk duhet të
11 publikohen. Por ky argument nuk është i vërtetë, është i
12 gënjeshtërt në disa nivele.

13 Së pari, në qoftë se kryesi i paralajmëron marrësit se do
14 të kryejë një vepër penale duke shpërndarë këtë informacion,
15 kjo është provë se kryesi e di që sjellja e vetë është
16 kriminale. Pra, ai bën atë që vetë thotë se është e ndaluar.
17 Dhe kryesi nuk mund të jetë më pak fajtor bazuar në faktin se
18 i ka thënë të tjerëve, ja u ka bërë të qartë të tjerëve që ajo
19 sjellje është e ndaluar.

20 Së dyti, të akuzuarit përdorin sofizma. Të akuzuarit
21 thonë se nuk janë fajtorë sepse nuk kanë dhënë emrat e
22 dëshmitarëve. Ata i dhanë vetë dokumentet konfidenciale që
23 përmbajnë emrat e këtyre dëshmitarëve shtypit.

24 Ta lëmë mënjanë faktin, provat që e vërtetojnë plotësisht
25 se të akuzuarit kanë përmendur emrat e dëshmitarëve në

1 konferencat e shtypit dhe në paraqitjet në televizion. Por
2 këtu çështja është se dhënia e dokumenteve konfidenciale,
3 vetëm ky akt, të akuzuarit me anë të tij kanë zbuluar
4 informacion konfidencial dhe të privilegjuar. Neni 392 nuk
5 përmban ndonjë kriter që informacioni konfidencial të jepet
6 gojarisht. Mund të komunikohet dhe në mënyra të tjera.

7 Sikur, mendo sesi mund ta gjejmë që ta shpjegojmë
8 argumentin e Mbrojtjes, një shembull i mirë është ajo që është
9 dëgjuar këtu në këtë sallë të gjyqit. Një dëshmitar, Rashit
10 Çelaj, u pyet nga Mbrojtja e Haradinajt për të shkruar tre
11 emra në letër në vend që t'i thoshte me zë këtu.

12 Më vonë, Mbrojtja e shikoi këtë dhe e kuptoj me shumë
13 çudi, që në letër nuk ishte emri i zyrtarit të ZPS-së që
14 shpresonte të gjente atje. Çështja nuk është që Mbrojtja e
15 bëri këtë bast të gabuar me këtë dëshmitar dhe ky në të
16 njëjtën mënyrë u mohua këtu, në Gjykatë, pikërisht argumenti i
17 tyre që ishin detyruar. Dhe, pra, çështja e Mbrojtjes këtu dhe
18 e ZPS-së është që ne i dëgjuam të gjithë këto emrat. Reshit
19 Çelaj, a i tha me zë të lartë? Jo. A e dha këtë informacion?
20 Po. E morëm atë. Tani e dimë se ç'ishte ky informacion.

21 Në të njëjtën mënyrë, i akuzuari i nxori emrat
22 konfidencialë të dëshmitarëve të mbrojtur dhe ja dha këtë një
23 numër prej pjesëmarrësve në konferencën e shtypit në të
24 shkruar duke ju dhënë atyre printime, pra, dokumentet
25 konfidenciale, vetë dokumentet konfidenciale.

1 I akuzuari ia ka dhënë këto dokumenteve vetëm anëtarëve
2 përgjegjës të shtypit është në fakt një përpjekje e pa bazë
3 për të hequr përgjegjësinë penale të të akuzuarit. E para, kjo
4 është çështje penale faktike. I akuzuari e ka bërë të qartë se
5 kushdo që hynte në zyrat e organizatës mund të hynte pa
6 kontroll - që të gjithë që kanë marrë pjesë në konferencat e
7 shtypit mund t'i kenë marrë ato dokumente pavarësisht nëse
8 ishin dokumente apo jo. E dyta, si çështje juridike. Anëtarët
9 e juridikut nuk janë personat e autorizuar për të marrë
10 informacionin konfidencial që ka të bëjë me hetime penale. Nuk
11 ka bazë ligjore për të thënë të kundërtën. E treta, çështje
12 logjike. A munden mbrojtësit e të akuzuarit të imagjinojnë një
13 sistem ligjor i cili parashikon që procedurat penale të mund
14 të mosxirren me përjashtim të rastit kur ato mund të jepen në
15 mënyrë të ligjshme për anëtarët e shtypit? Ideja është
16 qesharake pasi nuk ka asnjë mënyrë më të mirë për ta bërë
17 publik këtë. Sistemi ligjor i Kosovës nuk e përfshin këtë ide.

18 Edhe, më në fund, më lejoni të kujtoj, që të mos ketë
19 keqpërfaqësim të fakteve, si të thuash që i akuzuari ka thënë
20 në atë kohë që publikimi i emrave të dëshmitarëve është i
21 ndaluar me ligj dhe e kanë bërë në mënyrë të përsëritur këtë,
22 duke ia dhënë anëtarëve të shtypit. E kanë publikuar këtë
23 dokument edhe këto emra. Po jap disa shembuj.

24 Gjatë konferencës së tretë të shtypit, që është në P35,
25 faqe 13, 14, Hysni Gucati e kujtoj që i kishte botuar emrat e

1 të ashtuquajtur "veteranë të rremë" dhe tha, në të njëjtën
2 mënyrë, që emrat e dokumentacionit duheshin publikuar duke
3 thënë që "ato janë shqiptarë. Po ashtu që 80 për qind e atyre
4 që kanë dhënë dëshmi janë shqiptarë".

5 Gucati më tutje i tha shtypit që të kishte të njëjtën, të
6 tregonte të njëjtin guxim siç kanë bërë edhe me veteranët e
7 rremë. Dhe i akuzuari, në fakt, nuk e fshehu kërkesën e
8 vazhdueshme të shtypit që dokumentet konfidenciale, përfshirë
9 emrat e dëshmitarëve, të publikohen sa më shumë që të jetë e
10 mundur.

11 Gjatë debatit të zjarhtë, Nasim Haradinaj, në fakt, ju
12 tërhoqi vërejtjen gazetarëve që nuk kishin publikuar materiale
13 konfidenciale aq sa duhet; dhe ky është dokumenti P30. Kur u
14 pyet nga një gazetar çfarë dëshironte që të bënte media, duke
15 qenë që ishte duke bërë këtë debat, Haradinaj tha se donte që
16 media të publikonte aq sa kishin guximin ta bënin.

17 Megjithëkëtë, për sa i përket veprimeve të të akuzuarit,
18 të gjitha këto janë diskutuar gjerësisht me parashtrimet e
19 shkruara të ZPS-së.

20 Unë do të diskutoj disa prej këtyre çështjeve këtu dhe do
21 t'ju përgjigjemi pyetjeve nëse ka nevojë.

22 E para, dokumentet e shpërndara nga i akuzuari ishin
23 konfidenciale sipas nenit 392. Trupi Gjykues ka dëgjuar në
24 fakt dëshmi të pakontestueshme nga hetuesi i ZPS-së që të
25 gjitha materialet e nxjerra nga i akuzuari, kishin të bënin me

1 hetime konfidenciale dhe janë trajtuar si të tilla, siç janë
2 të gjitha, në varg të procesverbalit e veprimeve hetuese.

3 Të gjitha materialet e nxjerra të këtij grupi
4 dokumentesh konfirmojnë, në mënyrë të hapur, që këto materiale
5 ishin procesverbale konfidenciale të hetimeve apo analizë e
6 brendshme e materialeve hetuese dhe në fakt, kishin edhe
7 shenja që tregonin një gjë të tillë. E vetë të akuzuarit kanë
8 thënë që materialet ishin konfidenciale, sekrete dhe e thanë
9 këtë në momentin që i janë shpërndarë shtypit.

10 Tërësia e argumentit të Mbrojtjes që kërkesa e
11 konfidencialitetit nuk është përmbushur, në fakt, është e
12 bazuar në keqinterpretimin e dispozitave të zbatueshme.
13 Mbrojtja pohon që për të gëzuar Mbrojtjen sipas 392(1),
14 informacioni duhet të jetë të deklarohet sekret sipas ligjit
15 03/L-178. Është ligji që ka të bëjë me interesat e sigurisë së
16 Kosovës dhe nuk ka asgjë të përbashkët me konfidencialitetin e
17 procedurave penale.

18 Për më tepër, nuk ka asnjë gjurmë të kësaj kërkesë në
19 gjuhën e qartë të nenit 392(1).

20 Në të njëjtën kohë pala Mbrojtëse vazhdon të injorojë në
21 dosjen e saj gjyqësore që neni 392(1) kriminalizon kryesisht
22 shpërndarjen e informacionit i cili nuk duhet nxjerrë, sipas
23 ligjit. Dokumentacioni që ka të bëjë me hetimet e ZPS-së dhe
24 të Task Forcës së Posaçme janë të mbrojtur sipas kuadrit
25 statutor të Dhomave të Specializuara të Kosovës minimalisht

1 sipas neneve 62, 35(2)(f), 54(8), 61(4) të ligjit, siç është
2 parashikuar edhe në Aktakuzën paragrafi 33, mes të tjerave dhe
3 në Vendimin e Konfirmuar.

4 Për sa i përket kërkesës së të akuzuarit për nxjerrje të
5 materialeve konfidenciale pa autorizim, asnjëri prej të
6 akuzuarve nuk ka thënë që janë autorizuar. Ata nuk janë
7 autorizuar dhe në fakt, ishin krenar që të vepronin pa
8 autorizimin e ZPS-së dhe kundër vendimeve gjyqësore. Nuk ka
9 kërkesë që informacioni i nxjerrë për personin që ka kryer një
10 krim gjatë procedurave ligjore të ekzistojë edhe gjatë gjyqit.
11 Një interpretim i tillë do të lejonte në faktin që të
12 tejkaloheshin të gjitha interesat e mbrojtura. Për shembull,
13 kur një person i tretë gjatë procedurave nxjerr informacion të
14 mbrojtur të siguruar përmes një të akuzuari i cili e ka marrë
15 përmes procedurës së hapur të nxjerrjes, kjo sjellje përsëri
16 do të dënohet. Informacioni duhet të jetë nxjerrë në një
17 procedurë zyrtare dhe jo ndaj një personi apo në një mënyrë të
18 caktuar. Procedurat ligjore përfshijnë hetimet e Prokurorisë
19 në bazë të nenit 376. Informacioni i nxjerrë gjatë procedurave
20 penale në procedurat ligjore sipas kuptimit të Kodit Penal të
21 Kosovës.

22 Paneli ka marrë prova që i akuzuari përmes deklaratave
23 konfidenciale sekrete apo sensitive të këtij informacioni dhe
24 kjo ka dalë, për shembull, në P1-ET, faqe 3, Haradinaj thotë
25 që dokumentet konfidenciale janë top sekret. Në P19, faqe 2,

1 Haradinaj thotë që dokumentet kanë edhe vulën dhe janë sekret.
2 Në P59, më 21 shtator 2020, Gucati tha që dokumentet janë
3 konfidenciale sensitive.

4 Kundër këtij dokumenti, nuk ka rëndësi nëse të akuzuarit
5 e kanë menduar se klasifikimi i këtyre dokumenteve është i
6 justifikuar. Në pika të caktuara të këtij gjyqi, pala
7 mbrojtëse ose të akuzuarit kanë sugjeruar që informacioni i
8 këtij dokumentacioni nuk ishte konfidencial për shkak se
9 dokumentet u kishin arritur këtyre të akuzuarve. Ky është një
10 argument i cili është pa bazë.

11 ZPS-ja apo Task Forca Hetuese i klasifikon hetimet penale
12 si konfidenciale dhe kuadri ligjor apo korniza ligjore e
13 Dhomave të Specializuara të Kosovës konfirmon që këto
14 materiale nuk duhet të trajtohen si dokumente publikë; neni 62
15 i ligjit. Këto klasifikime mund të amendohen juridikisht sipas
16 rregullit 82(5) të Dhomave të Specializuara, por jo nga
17 arritja e këtyre grupe dokumentesh në Organizatën e Veteranëve
18 dhe sipas vendimit të vetë të akuzuarit. Po të ishte ndryshe,
19 konfidencialiteti i informacioneve kritike do të humbte
20 Mbrojtjen. Dhe prandaj ky është paradoksi që të akuzuarit
21 dëshirojnë të pohojnë në këtë drejtim.

22 Për shembull, në dokumentin P6-ET, në faqen 19 dhe 20,
23 kur një gazetar tha që ai nuk duhet t'i kishte shpërndarë këto
24 dokumente, Haradinaj u përgjigj -- gazetari i tha që nuk duhet
25 të kishte nxjerrë informacion sensitiv. Haradinaj u përgjigj:

1 "Kush janë këto dokumente? Ato janë dokumente sensitive
2 për Tribunalin e Hagës i cili bashkëpunon me Serbinë po nuk
3 janë sensitive apo të natyrës së ndjeshme për mua".

4 Nuk ekzistojnë dokumente konfidenciale për këtë
5 institucion që të mos jenë konfidenciale edhe për të
6 akuzuarit. Haradinaj nuk ka patur autoritet për të dhunuar
7 klasifikimin e këtyre dokumenteve thjesht duke ndjekur
8 dëshirën e tij. Kur thotë që dokumentet e Hagës nuk janë të
9 ndjeshme, i akuzuari shpreh pikërisht mosrespektimin e natyrës
10 konfidenciale të dokumenteve. Dhe ai e shpreh edhe dëshirën
11 për t'i shpërndarë këto dokumente pa mbajtur parasysh faktin
12 që këto janë dokumente konfidenciale, sipas nenit 21 të ligjit
13 të Kodit Penal.

14 Lidhur me kërkesat e posaçme të Aktakuzës së gjashtë,
15 dhunimi i sekretit të procedurave duke nxjerrë identitetin e
16 personave apo të dhënat mbi personat e mbrojtur. I akuzuari,
17 në konferencën e tij të parë të shtypit, nuk mund të ishte më
18 i qartë kur tha që i ka ditur emrat e personave, dëshmitarëve
19 të mbrojtur. Nasim Haradinaj thotë:

20 "... këto janë emrat e tërë dëshmitarëve që ato thonë që
21 janë nën mbrojtjen e tyre. Të tërë".

22 Dhe më pas u referohet atyre "të dhënave sekrete" lidhur
23 me këta dëshmitarë.

24 Dhe faktit që materialet përmbajnë pikërisht dëshmitë e
25 këtyre dëshmitarëve të mbrojtur. Ai më pas thotë që çfarë mund

1 të kërkohet tjetër, përveç fjalëve të vetë të akuzuarve?
2 Përveç kësaj, hetuesi i ZPS-së tha që grupi i tretë i
3 dokumenteve kishte referenca ndaj 150 dëshmitarëve të ZPS-së.
4 Grupi 1 dhe 2 kishin po kështu informacion të njëjtë të qindra
5 dëshmitarëve të mbrojtur.

6 Dhe përpjekjet e Mbrojtjes për të bërë një argument
7 ligjor që thotë, në kundërshtim me të akuzuarit dhe në
8 kundërshtim me atë që ka thënë hetuesi i ZPS-së, që individët
9 të cilët nuk janë të mbrojtur në bazë të nenit 392 të ligjit
10 kriminal të Kosovës ishin aty në këtë dokument.

11 Dhe më lejoni të them, që dokument -- fakti që dy emrat e
12 dëshmitarëve dhe dëshmia e tyre ishin pjesë e dokumenteve të
13 brendshme të Task Forcës Hetuese mjafton si fakt për ta
14 mbrojtur këtë person sipas ligjit. Dhe kjo është e bazuar në
15 nenin 62 të Ligjit, siç gjendet edhe në dokumentin e
16 konfirmuar. Përveç kësaj, Trupi Gjykues ka dëgjuar dëshmi të
17 mjaftueshme lidhur me mocionet sipas nenit 35(2)(f) të Ligjit
18 dhe 32(a) të Rregullores. Dokumente të cilat kanë emrat e
19 dëshmitarëve janë të shënuara si konfidenciale dhe në rastin e
20 grupit të tretë të dokumenteve, janë dokumente të brendshme të
21 punës. ZPS-ja ka thënë që këto janë konfidenciale. Asnjë prej
22 emrave nuk është nxjerrë nga ZPS-ja përpara sjelljes së të
23 akuzuarit dhe ZPS-ja e ka kërkuar që të nxirreshin urdhra për
24 mosnxjerrjen lidhur me Aktakuzat e asaj kohe. Kjo bazë mjafton
25 për të pranuar faktin që këto emra janë të mbrojtur.

1 Në kundërshtim me atë që thotë Mbrojtja, neni 392(2) nuk
2 kërkon që të ketë masa të veçanta specifike të Mbrojtjes me
3 qëllim që një personi t'i jepet statusi i personit të mbrojtur
4 gjatë një inspektimi penal.

5 Mbrojtja injoron një çështje themeltare kur thotë që
6 duhet marrë masa të veçanta mbrojtëse në këtë drejtim. Po të
7 ishte kështu, neni 392, nuk do të siguronte asnjë lloj
8 mbrojtjeje në fazën hetuese.

9 Masat e posaçme të Mbrojtjes për dëshmitarë të caktuar
10 mund të aktivizohen në faza të caktuara të procedurave kur
11 Prokuroria duhet t'i nxjerrë këto sipas ligjit. Dhe kur lind
12 nevoja për ta përmbushur këtë detyrim. Atëherë masat e veçanta
13 të Mbrojtjes mund të miratohen për të ruajtur dëshminë e një
14 dëshmitari të caktuar që të mos nxirret, ndërkohë që pjesa
15 tjetër e dëshmisë të nxirret edhe në fazën hetimore.
16 Sidoqoftë, nuk ka detyrim për palën e ZPS-së, ku të gjitha
17 materialet hetuese janë konfidenciale, kur të gjithë
18 dëshmitarët kanë të njëjtin nivel të mbrojtjes. Rregulli është
19 i konfidencialitetit pa përjashtim. Të gjithë dëshmitarët e
20 mbrojtur, të gjithë që kanë bashkëpunuar kanë statusin e
21 dëshmitarit të mbrojtur sipas ligjit.

22 Në këtë kuadër, ZPS-ja ka dhënë edhe dëshminë tjetër
23 lidhur me statusin e kualifikuar të disa prej dëshmitarëve të
24 mbrojtur të Dosjes 3. Por, le ta bëjë të qartë, Aktakuzën 6
25 është aprovuar me ose pa dëshminë shtesë.

1 Për shembull, hetuesi i ZPS-së tha që për sa i përket
2 dëshmitarëve të Dosjes 3, Gjykatësi i Dhomave të Specializuara
3 ka nxjerrë urdhra për mosnxjerrjen e informacionit. Dhe urdhri
4 i këtij dëshmitari është shumë i qartë: Informacioni lidhur me
5 identitetin e disa dëshmitarëve nuk duhej nxjerrë as personave
6 të akuzuar në procedurat e tjera penale pas paraqitjes së tyre
7 të parë, le më për publikun e gjerë.

8 I akuzuari i parë i Dhomave të Specializuara është
9 arrestuar pas nxjerrjes së dokumenteve të Dosjes 3 më datën 22
10 shtator. Ky nuk është urdhri që do t'i kishte përmbushur të
11 gjitha masat e Mbrojtjes të cilat përmend Mbrojtja dhe që janë
12 kërkesat 392 të Kodit Penal. Nuk është kjo kërkesë, megjithatë
13 është provuar.

14 Për sa i përket njoftimit të paragrafit 3 të nenit 392 të
15 Kodit Penal të Kosovës. Në thelb të kësaj figure penale, sipas
16 nenit 392(2) të Kodit Penal, nuk kërkohet që të ketë nxjerrje
17 të informacionit të mbrojtur në mënyrë të paautorizuar, pasi
18 ai ka pasoja të rënda për personat e mbrojtur apo në rastet
19 kur procedurat penale janë penguar apo janë bërë të pamundura.
20 ZPS-ja në dosjen e saj të fundit e ka trajtuar në hollësi të
21 gjitha këto pasoja.

22 Dhe, më lejoni që të paraqes, t'ju kujtoj që prindërit e
23 dëshmitarit, dokumentet e të cilit janë nxjerrë nga të
24 akuzuarit, thanë që ata ishin të shqetësuar, të stresuar, të
25 pasigurt, të kanosur pas botimit të tyre. Dhe ZPS-së ju desh

1 që të merrte masa të shumta të sigurisë, duke përfshirë planet
2 e rrezikut të emergjencës dhe nxjerrjen jashtë territorit të
3 Kosovës. Masa sigurie dhe masa për zhvendosje janë marrë për
4 shumë dëshmitarë në mbi 20 deri në 30 dëshmitarë. Ndërkohë
5 zhvendosjet janë ndërmarrë nga ZPS-ja për persona të cilët
6 kanë qenë të frikësuar dhe nuk dëshironin që të qëndronin më
7 në shtëpitë e tyre pas botimit të dokumenteve nga OVL e UÇK-
8 së. Zhvendosja është një masë përjashtimore, një masë e
9 skajshme dhe që ndërmerret vetëm atëherë kur ZPS-ja nuk ka
10 opsione të tjera për të mbrojtur dikë që është në Kosovë. Disa
11 persona janë shkurajuar për të bashkëpunuar më me ZPS-në,
12 ashtu siç është dëshmuar edhe nga hetuesit e ZPS-së.

13 Zoti Halling, më pas do t'i kushtojë disa kohë për t'ju
14 përgjigjur specifikisht aspekteve të cilat kanë të bëjnë me
15 mosmbështetjen dhe mospranueshmërinë e provave të cilat janë
16 dhënë nga pala tjetër.

17 Megjithatë, për momentin, më lejoni që t'ju jap një burim
18 mbështetjeje të provave të cilat janë paraqitur nga ZPS-ja, të
19 cilat duhet të konsiderohen si të bazuara dhe të mbështetura
20 edhe nga Mbrojtja.

21 Kjo është dëshmia e zotit Gucati në kuadër të këtij
22 gjykimi. Në faqen 2389 [sipas përkthimit] dhe 2308 të
23 transkriptit dhe zoti Gucati thotë:

24 "... që në qoftë se unë do të nxirrja një emër vetë në
25 kryesinë e OVL së UÇK-së, sigurisht që neve do të kishim

1 dëmtuar në një farë mënyre dëshmitarët”.

2 Ai vazhdon më tej duke thënë:

3 “Në qoftë se ne nxjerrim emra, ne mbase mund të vendosnim
4 në rrezik dikë”.

5 Z. REES: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, por ky fragment
6 është korrigjuar nga Njësia e Përkthimit.

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Atëherë do t’i referohem
8 versionit të korrigjuar të transkriptit, të nderuar Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e di në
10 qoftë se mund ta bëni këtë gjë. Nuk e di në qoftë se do ta
11 prezantoni sot apo jo?

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Siç e thashë, domethënë, do jap
13 versionin e korrigjuar të transkriptit.

14 Haradinaj po ashtu në mënyrë të ngjashme konfirmoi në
15 gjykim që nxjerrja e emrave të dëshmitarëve mund të kishte
16 shkaktuar vdekjen e dikujt ose mund të kishte frikësuar për
17 vdekje dikë. I akuzuari e deklaroi këtë, në mënyrë të
18 përsëritur, duke thënë që nxjerrja e emrave të dëshmitarëve do
19 të cenonte sigurinë e tyre. Në fakt, kjo është tërësisht e
20 saktë, dëshmitarët e dinin këtë gjë ashtu siç e dinin dhe të
21 akuzuarit. Është vetëm realiste që rreziqet u rritën për
22 dëshmitarët ashtu siç ata u ndjenë të frikësuar, ndërkohë që
23 nxirreshin emrin e tyre dhe ndërkohë që kanë dëshmuar dhe
24 oficerët e sigurisë së dëshmitarëve të ZPS-së.

25 Ne e dinim që nxjerrja e emrave të dëshmitarëve do të

1 cenonte dëshmitarët. Ne nuk kemi nxjerrë emra të dëshmitarëve.
2 Siç mund ta shikoni, ne nuk duam që të dëmtojmë apo të cenojmë
3 dëshmitarët. Dhe ndërkohë propozimi i dytë i këtij arsyetimi
4 është i rremë. Në fakt, të akuzuarit kanë nxjerrë emrat e
5 dëshmitarëve. Ata e dinin që nxjerrja e dëshmitarëve do të
6 dëmtonte, do të cenonte ata, po pavarësisht kësaj ata i kanë
7 nxjerrë emrat e dëshmitarëve. Përfundimi i vetëm i arsyeshëm
8 është që ata synonin që të shkaktonin pasoja të rënda për të
9 gjitha veprimet e prodhuara.

10 Në përfundim, të gjithë elementet e pikës 5 dhe 6 të
11 dokumenteve janë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm,
12 përfshirë edhe formën rënduese të veprës penale e cila
13 parashikohet sipas nenit 392(3) të Kodit Penal.

14 Tani, le të kalojmë me pikën tjetër, që është pika 3 e
15 Aktakuzës, që është një ndër pikat kryesore të Aktakuzës. Më
16 lejoni të them që vetëm disa përzgjedhje, vetëm disa copëza të
17 dëshmive që kemi dëgjuar janë të mjaftueshme për të provuar
18 përtej dyshimit të arsyeshëm që të akuzuarit kanë përdorur
19 kërcënime të rënda për të frikësuar personat ose për të dhënë
20 deklaratat të rreme për ZPS-së apo DHSK-në.

21 Por ka më shumë sesa kaq.

22 Të akuzuarit jo vetëm që kanë dhënë, kanë nxjerrë
23 informacion konfidencial për personat e mbrojtur por ata e
24 kanë bërë një gjë të tillë në mënyrën më të zhurmshme të
25 mundshme. Ata kanë njoftuar nxjerrjen e informacionit për

1 personat e mbrojtur në kuadër të konferencave për shtyp që
2 janë transmetuar drejt për së drejti. Ata kanë marrë pjesë në
3 një numër të konsiderueshëm të programeve televizive në një
4 periudhë të shkurtër kohe për të siguruar që i njëjti mesazh
5 të përsëritej herë pas here, pra, që presioni mbi dëshmitarët
6 do të ishte i lartë.

7 Dhe çfarë mesazhi i kanë dhënë ata publikut të
8 përgjithshëm dhe shumë dëshmitarëve që janë anëtarë të
9 publikut? Mesazhi që Haradinaj vetë ka artikuluar pas
10 konferencës së parë për shtyp. Që është prova materiale P1-ET,
11 faqja 3, "tani të gjithë dëshmitarët e ZPS-së duhet të dinë që
12 emrat dhe mbiemrat e tyre janë të ditur, që askush nuk është i
13 paditur dhe që deklaratat dëshmitarëve po shpërndahen".

14 I akuzuari i dha një mesazh të pagabueshëm dëshmitarëve
15 që identiteti ishte në domenin publik dhe që identiteti i tyre
16 nuk mund të mbrohej më. A kanë qenë fjalë të tilla të afta që
17 t'i bëjnë dëshmitarët që të frenohen nga bërja e deklaratave
18 ose që t'i japin deklaratat të rreme? Trupi Gjykes që dëgjoi
19 edhe vetë ekspertët hetimorë të Mbrojtjes së Haradinajt e
20 pranuan që vetëm fjalët mund të kenë ndikim kërcënues mbi
21 dëshmitarët.

22 I akuzuari e njohu që nuk është se ka drejtuar ndonjë
23 mesazh specifik ndaj një individi. Është e vërtetë, në fakt,
24 që në Aktakuzë nuk themi që kërcënimet janë ngritur ndaj një
25 individi të vetëm apo ndaj pesë apo dhjetë individëve të

1 ndryshëm. Por, në fakt, mesazhet janë drejtuar për të gjithë
2 ata dëshmitarë apo për të gjithë personat të cilët kanë
3 ndërvepruar me SFHT-në, me ZPS-në dhe ato të cilët janë
4 përmendur në këto paketa janë një pjesë e atyre personave të
5 cilët kanë qenë objekt i mesazheve.

6 Mbështetur në atë çfarë kemi gjurmuar në kohën e
7 sekuestrimit, në Paketën 2, kemi më pak informacion sesa në
8 paketat e tjera. Megjithatë pavarësisht janë theksuar mesazhet
9 kërcënuese të të akuzuarit. Fakti që i akuzuari ka deklaruar
10 se ka informacion shtesë për sa i takon dëshmitarëve që po
11 nxirren në vetvete është po aq efektiv sa vetë nxjerrja e
12 informacionit.

13 Në qoftë se është e vërtetë që një fotografi ka vlerë më
14 shumë sesa një mijë fjalë, sa e madhe është fuqia e shumë
15 deklaratave në formatin video të cilat qarkullojnë nga një
16 person tek tjetri, nga një aparat teknologjik tek tjetri, nga
17 një shtëpi tek tjetra, ku përsëritej që ne e dimë kush jeni ju
18 dhe mos mendoni se do t'ju mbrojë njeri tani.

19 Provat tregojnë më tej që të akuzuarit jo vetëm i kanë
20 thënë dëshmitarëve që identiteti i tyre ishte i njohur. Por,
21 në të njëjtën kohë që deklarorin që të dhënat e dëshmitarëve
22 do të bëheshin publik, Haradinaj dhe Gucati kanë akuzuar
23 dëshmitarët se janë spiunë, tradhtarë, bashkëpunëtorë,
24 kolaboracionist kriminal, thithës gjaku dhe folës shqiptarë.

25 Në momente të ndryshme gjatë këtij procesi, të akuzuarit

1 janë munduar që të ulin kuptimin e fjalëve apo të akuzave të
2 tilla. Megjithatë, fuqia kërcënuese e fjalëve të tyre dhe
3 interpretimi i kuptimit të tyre, shpjegohet në fakt në shumë
4 momente të rëndësishme nga vetë të akuzuarit. Për shembull, në
5 të njëjtën kohë, ndërkohë që ata i janë referuar -- Gucati
6 ndërkohë që i është referuar dëshmitarëve si folës shqiptarë,
7 Gucati ka qartësuar dhe kjo jepet specifikisht në provën P90-
8 ET, faqja 10 dhe 12, që me shqipfolës ai nënkupton "tradhtarët
9 e vendit tonë", ata të cilët nuk kanë interesat më të mira të
10 Kosovës në mendje. Dhe me këtë rast, i akuzuari, pra, i është
11 drejtuar dëshmitarëve për sa i takon bashkëpunimit të tyre me
12 këtë Gjykatë.

13 Dhe sa i takon kuptimit të akuzimit të dëshmitarëve se
14 janë spiunë serbë, kjo në vetvete është sqaruar me detaje nga
15 Haradinaj vetë ndërkohë që ka dhënë dëshminë e tij këtu
16 përpara Gjykatës. Dhe më lejoni, ju lutem, që të transmetoj
17 një segment në versionin anglisht së bashku me versionin në
18 shqip.

19 [Luhet videoincizimi]

20 PËRKTHYESJA: "Ata na kanë akuzuar se keni bashkëpunuar me
21 serbët me dokumentet këtu. Dhe akuzimi i njerëzve se kanë
22 marrë pjesë si kolaboracionistë, është i shërbimeve serbe
23 sekrete, është akuza fundore për sa i takon këtij niveli".

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Akuzimi i njerëzve që marrin
25 pjesë në ligj, që ti je kolaboracionist në vetvete domethënë

1 dhe për sa i takon shërbimeve sekrete serbe, është akuza më e
2 madhe e nivelit më të lartë”.

3 Fjalët e të akuzuarit duhet të kuptohen gjithashtu edhe
4 në kuadrin e frymës së frikësimit të të akuzuarve që është e
5 pranishme kundër shumë personave në Kosovë. Vendimi i Gjykatës
6 ka theksuar që si ZPS-ja dhe dëshmitarët e Mbrojtjes e
7 përshkruajnë këtë situatë si realitet.

8 Ekspertët e dëshmisë kanë krahasuar që të jesh dëshmitar
9 në proces gjyqësor është e njëjta si tradhtar në një kauzë.
10 Dhe një dëshmitar, gjithashtu, ka afirmuar që nuk ka parë
11 asgjë të tillë të ngjashme si frikësimin e dëshmitarëve në
12 proceset gjyqësore në Kosovë. Madje as edhe në rastet e
13 krimeve të organizuar.

14 Gucati nuk ishte i gatshëm që të deklaronte në Gjykatë që
15 kishte një klimë frikësimi të dëshmitarëve në Kosovë dhe tha
16 që ishte e pamundur që dikush që është në Kosovë të mos ishte
17 i informuar për proceset gjyqësore kundër anëtarëve të UÇK-së.
18 Ai tha se, në qoftë se ti largohesh nga Kosova dhe nuk ke
19 dijeni për procese gjyqësore, kjo është një situatë e
20 pamundur. Megjithatë, proceset gjyqësore kundër pjesëtarëve të
21 UÇK-së janë të njohura për të gjithë. Janë të njohura jo vetë
22 për personat në të 50-at, si puna ime, por edhe çdo fëmijë në
23 Kosovë janë të informuar për proceset gjyqësore kundër
24 pjesëtarëve të UÇK-së.

25 Dhe, në fakt, gjatë kohës së Aktakuzës, të akuzuarit janë

1 referuar historisë së frikësimit për të përforcuar kërcënimet
2 e tyre. Kjo është, për shembull, ajo çfarë ka bërë Haradinaj
3 kur ka deklaruar në P8-ET, faqja 26, se "paketa e parë synonte
4 vetëm thjesht të na informonte: Ju budallenj, ju frikacakë, ju
5 spiunë, mos mendoni se dikush do t'ju mbrojë por do t'ju
6 përdorë sepse nuk ka asnjë histori në botë që e tregon se
7 spiunët mbrohen. Ata ose vriten ose diskriminohen ose janë
8 tjetërsuar. Kështu që çfarë pritshmërie të tillë mund të keni
9 juve, si mund të mendoni që mund të spiunoni njerëzit tuaj dhe
10 të tradhtoni njerëzit tuaj dhe ndërkohë ju duhet të mbroheni
11 nga të tjerët".

12 Pra, ishte shumë e qartë në deklaratën e Haradinajt, që i
13 akuzuari synonte që të dërgonte një mesazh për viktimat që,
14 siç kishte ndodhur në të shkuarën, personat që bashkëpunonin
15 me autoritet gjyqësore do të vriteshin ose do të
16 diskretitoheshin.

17 Në një pjesë veçanërisht evazive të dëshmisë së
18 Haradinajt, ai u mundua që të distancohej nga këto fjalë duke
19 thënë që i kishte thënë këto fjalë në disa programe televizive
20 dhe po fliste për kolaboracionistët nga një perspektivë
21 historike. Një interpretim i tillë është i papranueshëm.
22 Sepse, së pari, ai i referohej posaçërisht personave të cilët
23 përmendeshin në Paketën 1. Por mbi të gjitha kemi parë një
24 videoincizim për të vlerësuar vetë Trupi Gjyqësor në qoftë se
25 ka pasur ndonjë gjurmë satire në atë çfarë ka thënë zoti

1 Haradinaj. Situata, në fakt, është tërësisht e ndryshme nga
2 ajo çfarë u përpoq zoti Haradinaj që të na thoshte në Gjykatë
3 dhe ishte një situatë e një kërcënimi të rëndë.

4 Vepra penale e frikësimit sipas nenit përkatës të Kodit
5 Penal të Kosovës është një krim i mëvetësishëm, është një krim
6 i veçantë, çfarë do të thotë që nuk do të duhet që të lidhet
7 me veprime të tjera të të akuzuarve.

8 Provat tregojnë që kërcënimet e rënda të të akuzuarit
9 kishin mundësinë që të shtynin dhe ishin synuar që të shtynin
10 persona nga mosdeklarimi përpara DHSK-së ose ZPS-së ose bërja
11 e deklaratave të rreme. Prova të cilat janë dhënë në këtë
12 proces gjyqësor që personat që dëshmitarët janë ndjerë të
13 kërcënuar dhe persona të tjerë janë tërhequr nga angazhimi i
14 tyre dhe përfshirja e tyre me ZPS-në është një tjetër tregues
15 që veprimet e të akuzuarit kanë pasur potencialin për ta bërë
16 këtë gjë.

17 Përgjegjësia e të akuzuarit nën pikën 3 të Aktakuzës
18 është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

19 Sa i takon pikës 4, hakmarrjes. U bë e qartë gjatë
20 procesit gjyqësor që përmes veprimeve të tyre të akuzuarit jo
21 vetëm dëshironin që të shkurajonin dëshmitarët që të jepnin
22 prova për DHSK-në dhe ZPS-në, po gjithashtu, dëshironin që të
23 ndëshkonin të gjithë ata të cilët kishin bashkëpunuar dhe që
24 kishin dhënë një deklaratë për këtë.

25 Në një postim në FaceBook që është përpara periudhës së

1 Aktakuzës, më 4 korrik 2020, Gucati e përshkruan procesin
2 gjyqësor në këtë Gjykatë si një betejë midis tradhtarëve të
3 Kosovës, spiunëve të Serbisë që duan të bashkëpunojnë me
4 Gjykatën dhe mbështetësve të UÇK-së. Dhe ai paralajmëroi se
5 këta, në këtë betejë, njerëzve do t'u përmendeshin emrat dhe
6 do të turpëroheshin.

7 Veprimet e të akuzuarve nga data 7 deri 25 shtator 2020 e
8 plotësuan këtë premtim. Të akuzuarit botuan identitetet e
9 atyre që kishin bashkëpunuar me autoritet hetuese dhe këta do
10 të ekspozoheshin, të turpëroheshin, marginalizoheshin dhe
11 dëmtoheshin. Për shembull, këtë bën Gucati në një intervistë
12 më 7 shtator, menjëherë pas konferencës së parë të shtypit në
13 P9, kur ai tha që "ai pa që kishte shumë njerëz të cilët ne i
14 besonim që të cilët kishin besim që i kishim mirëpritur në
15 shpitë tona, i kemi takuar, i kemi respektuar".

16 Dhe, kur, pastaj, në të njëjtën vend shton po këta
17 persona ishin bashkëpunëtor të Serbisë, kur dhe ata ai i
18 quajti si persona që ndihmonin Serbinë dhe që donin të gjenin
19 informacione për t'ia paraqitur Gjykatës.

20 Të nderuar Gjykatës, ajo që kërkohet për hakmarrjen sipas
21 nenit 388(1) e Kodit Penal është që të ketë veprim dëmtues. Që
22 veprimi shkakton dëmtim, nuk është pjesë e kësaj vepre penale.
23 Kodi e thotë këtë për vepra të tjera penale në lidhje me
24 administrimin e drejtë të drejtësisë. Neni 388(1) është
25 shembull i këtij veprimi duke ju referuar "çdo veprimi që

1 është dëmtues për çdo person, përfshirë dhe ndërhyrjen me
2 punësimin dhe fitimin e jetesës në mënyrë të ligjshme". Kjo
3 shpjegon se dëmtimi ishte i qëllimshëm dhe Mbrojtja argumenton
4 që, dëmtimi që kishin parasysh ata, nuk ishte një dëmtim i
5 dhunës, po e sqaron është se nuk ka nevojë të shkaktohet ajo
6 dhunë. Po faktikisht janë veprimet ato që kanë rëndësi.
7 Ndërhyrja tek këta dëshmitarë dhe interesat e tyre pavarësisht
8 nga pasojat.

9 Dëshmitarët u dëmtuan nga sjellja e të akuzuarve edhe në
10 qoftë se vetëm të drejtat e privatësisë u shkelën edhe kjo do
11 të ishte një shkelje. Por ka edhe më tepër. Siç e thamë edhe
12 më herët të akuzuarit krijuan rreziqe për sigurinë e
13 dëshmitarëve dhe për mirëqenien e tyre. Dëshmitarët kishin
14 frikë, humbën besimin se ata dhe familjet e tyre do të
15 mbroheshin. Disa dëshmitarë ishin kaq shumë në rrezik sa që u
16 desh të zhvendoseshin me vendbanim.

17 Në mënyrë që të ketë hakmarrje, kryesi duhet të veprojë
18 me qëllimin specifik për të marrë hak ndaj dëshmitarëve për
19 dhënien e informacionit të vërtetë prej tyre në lidhje me
20 kryerjen apo kryerjen e mundshme të një vepre penale.

21 Nëse të akuzuarit e dinin apo jo që ky informacion ishte
22 objektivisht i vërtetë nuk kërkohet. Një interpretim i kundërt
23 i kësaj do të çonte në një hetim dispropocional sepse çdo
24 gjykim, në lidhje me hakmarrjen në Kosovë do të përfshinte
25 edhe një gjykim anësor në lidhje me besueshmërinë dhe

1 mbështetshmërinë e informacionit të dhënë nga dëshmitarët. Të
2 akuzuarit u përpoqën të mbrohen se informacioni që dhanë ata
3 mund të jetë i vërtetë, në përputhje me nenin 21 të ligjit
4 penal.

5 Të akuzuarit u përpoqën të mbroheshin duke thënë se
6 dëshmitarët në materialet që panë ata nuk ishin gjë tjetër
7 përveçse gënjeshtarë të cilët kishin dhënë dëshmi të rreme.
8 Megjithatë, kur u pyetën sesi e dinin këtë, që ky informacion
9 i përmbajtur në deklaratat e dëshmitarëve që kishin parë ata
10 ishin fabrikime, ishin gënjeshtër, të akuzuarit nuk mundën të
11 jepnin ndonjë shpjegim të arsyeshëm.

12 Për shembull, në dëshminë e tij, në faqen 2369 deri në
13 2370 të transkriptit, Gucati tha se ai kishte arritur në
14 përfundimin se dëshmitarët të cilët kishin dhënë deklaratat
15 kundër anëtarëve të UÇK-së kishin gënjyer pa i lexuar këto
16 deklaratat. Këtë e arriti, këtë përfundim, sepse asnjë anëtar i
17 UÇK-së nuk mund të kishte kryer krime. Dhe, pastaj, tha që u
18 ankua se Prokuroria po përpiqej të shkelte të drejtat e tij
19 për të thënë çfarë donte.

20 Por është pranohet -- a është e pranueshme, që ashtu siç
21 argumenton Mbrojtja, që për të ikur përgjegjësisë për
22 hakmarrje është e mjaftueshme që të akuzuarit të thonë që unë
23 e di që të gjithë të dyshuarit janë të pafajshëm dhe prandaj
24 dëshmitarët janë gënjeshtar? Fakti është që nuk ekzistonte
25 kritere që të akuzuarit duhet të jenë dakord me veprimet

1 penale që janë kryer. Çështja është se nëse i akuzuari e dinte
2 apo e kishte arsye të besueshme për të ditur se të gjithë
3 dëshmitarët ndaj të cilëve po merrej hak ishin të gjithë
4 shpifës. Çdo viktimë që dëshmohte për dëshmitë, për vuajtjet
5 që ka pësuar secili a e dinte këtë secili i akuzuar? Çdo
6 anëtar i familjes që ka treguar historinë e tyre për personat
7 e familjes të cilët janë zhdukur apo që kanë vuajtur, si mund
8 ta kishin ditur këta të akuzuar, që ata ishin gënjeshtar?

9 Por, fakti është që duke sulmuar të gjithë ata
10 bashkëpunonin me TFHS-në dhe ZPS-në, të akuzuarit, për nga
11 përkufizimi, sulmuan çdo histori të vërtetë që u tregua. Të
12 akuzuarit nuk mund të ishin në gjendje të dallonin midis
13 personave që i kishin dhënë informacion të vërtetë apo të
14 pavërtetë TFHS-së dhe ZPS-së, ndër ato qindra identitete që
15 shpërndanë. Të akuzuarit i përmendin këta dëshmitarë dhe i
16 quajnë "gënjeshtarë" vetëm për t'i diskretitur ata dhe për të
17 hedhur njollë mbi figurën e tyre për persona të cilët kanë
18 dhënë dëshmi për krimet e kryera që pretendohet se janë kryer
19 nga UÇK-ja.

20 Pra, të akuzuarit e dinin se informacioni që kishin në
21 posedim, përfshirë informacionin që ishte dhënë nga
22 dëshmitarët autorëve të Prokurorisë, mund të kenë qenë të
23 vërteta dhe kishin qëllim të merrnin hak kundër këtyre
24 dëshmitarëve që dhanë informacion të vërtetë. Si të tillë, jo
25 vetëm sjellja kriminale por edhe *mens rea*, qëllimi kriminal i

1 të akuzuarve është provuar, është vërtetuar përtej dyshimit të
2 arsyeshëm në këtë gjykim.

3 Për sa i përket pengimit të procedurave penale pika 1 e
4 Aktakuzës. Dua të kujtoj së pari se sa të fuqishme janë provat
5 në këtë çështje sa që qëllimi përfundimtar që ka të bëjë me
6 sjelljen e të akuzuarve ishte që ata kishin për qëllim të
7 pengonin këtë institucion që të kryente detyrat e veta.

8 Të akuzuarit nuk mund të ishin më të qartë, nuk mund ta
9 shprehnin më qartë sesa ata janë kundër DHSK-së edhe ZPS-së.

10 Kjo Gjykatë është monoetnike, është raciste. Praktikon
11 drejtësi selektive sepse nuk ndjek krimet serbe. Mbështetet
12 nga çdo tradhtar dhe spiun. Thërret dëshmitarët që janë armiq,
13 bashkëpunëtorë. Është një gjysëm drejtësi që është marrë nga
14 aparati i Millosheviçit.

15 Dhe gjatë këtij gjykimi, megjithëse ata u përpoqën, të
16 akuzuarit nuk mundën ta fshihnin përbuzjen për këtë
17 institucion.

18 Kur mjetet ligjore për të amenduar këtë institucion
19 dështuan dhe paketat e paraqitura ishin një mundësi shumë e
20 mirë, sipas fjalëve të Gucatit, ata e morën ligjin në duart e
21 tyre dhe vendosën ta pengojnë drejtësinë.

22 Për shembull, kur u pyetën nga një gazetar më 17 shtator
23 2020, që argumentoi se sjellja e të akuzuarve mund të kuptohej
24 si një përpjekje për të minuar administrimin e drejtësisë,
25 Gucati u përgjigj kështu:

1 "Të gjithë dokumentet që kam marrë nga Gjykata Speciale
2 në qoftë se dikush m'i sjell mua dhe m'i sjellë tek dera ime,
3 unë do t'i bëj ato publike... Në qoftë se do të mundnim do ta
4 hiqnim qafe këtë Gjykatë Speciale në pesë minuta. Ne do ta
5 shpërndajmë Gjykatën Speciale sepse është një gjykatë ... më
6 gjeni një vend në botë, kudo, ku ka pasur një luftë kur ka
7 pasur një gjykatë kaq të njëanshme".

8 Kjo është në faqen 11, në transkript P28-ET.

9 Po kështu në P35-ET, faqja 3, Haradinaj tha se OVL UÇK-ja
10 do të botonte "çdo gjë që do të merrnin që ekspozon këtë
11 Aktakuzë dhe aktakuzat që duan të ngrenë".

12 Në një rast tjetër, Haradinaj dhe Tomë Gashi thanë se
13 DHSK-ja duhet tani të mendohet dy herë përpara sesa të
14 konfirmonte aktakuzat.

15 Fjalët e Haradinajt janë edhe më të qarta. Ky pasazh
16 vijues është në P18, data 16 shtator.

17 [Luhet videoincizimi]

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Haradinaj u pyet nëse e dinte
19 nëse e dinte se ai do të dëmtonte procesin gjyqësor dhe ai tha
20 që "pikërisht këtë donte".

21 Një provë tjetër, që është në P8, data 20 shtator, ja
22 ç' thotë Haradinaj.

23 [Luhet videoincizimi]

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Me fjalët e vetë Haradinajt,
25 "Gjykata do të rrëzohet krejt sepse dëshmitarët e dinë kush

1 janë ata”.

2 Të nderuar Gjykatës, të gjitha veprimet e të akuzuarit
3 gjatë gjithë kësaj periudhe janë bërë me qëllimin për të
4 penguar punën e ZPS-së dhe të DHSK-së. Të gjitha këto janë
5 prova më se bindëse dhe janë në dosjen përfundimtare të ZPS-
6 së.

7 Mbrojtja, megjithatë, thotë se sjellja e të akuzuarve nuk
8 përmbush kriteret e qëllimit kriminal të veprës penale të
9 pengimit të drejtësisë sepse duhet të ketë, të përfshijë një
10 kërcënim të rëndë të përdorimit të forcës sipas nenit 401(1)
11 dhe (5).

12 Për sa i përket kërcënimit të rëndë si kërcënim për
13 përdorimin e forcës. Përpyekjet për të interpretuar këto
14 kritere të tjera që kërcënim i rëndë duhet të jetë kërcënim
15 me forcë, nuk ka bazë ligjore. Kuptimi i drejtpërdrejtë i
16 “kërcënimeve të rënda” nuk përmban ndonjë kufizim të tillë.
17 Dhe, për shembull, krimi i kërcënimit sipas nenit 181 në Kodin
18 Penal përmend “secili person që kërcënon rëndë me fjalë, me
19 akte, me vepra për të dëmtuar personat të tjerë dhe për të
20 frikësuar apo të shkaktuar ankth tek ata, përfshihet në këtë
21 kuadër”.

22 Po kështu dhe neni 182(2) i Kodit Penal, neni 114, neni
23 227(3).

24 Argumenti i Mbrojtjes se kjo veprë penale përfshihet në
25 veprat kundër rendit publik në Kod, po kështu nuk është

1 përfundimtar. Këtu nuk përfshihet dhe nuk përmbahet përdorimi
2 i forcës. Për shembull, ajo përfshin nenin 411, "Veprën penale
3 të dhënies së paligjshme të ndihmës" që nuk është krim dhune.

4 Në si përfundim, lloji i dëmit të shkaktuar nuk e
5 përcakton këtë lloj vepre penale për sa kohë që kërcënimi
6 arrin nivelin apo standardin e rëndësisë. Për shembull,
7 kërcënimi i dikujt që për të kompromentuar reputacionin e tij
8 apo të humbi punën mund të përfshihet në këtë kategori të
9 kërcënimit serioz.

10 Për sa i përket pikës së dytë, gjuha e qartë e nenit 401,
11 e shpjegon se çfarë është kërcënimi i rëndë dhe kjo mund të
12 drejtohet edhe ndaj personave të tretë të cilët kërcënohen
13 gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare.

14 Nuk ka asgjë të dykuptimtë apo të paqartë në formulimin e
15 Kodit Penal dhe as nuk është shkelje e parimit të
16 interpretimit të drejtpërdrejtë, interpretimit strikt, që të
17 mos interpretosh këto fjalë në dispozitën ligjore, si fjalë që
18 nuk janë shkruar atje. Ata janë përpjekur të kufizojnë se kush
19 mund të kërcënohet dhe në qoftë se donin ta bënin këtë duhet
20 t'i referoheshin neneve të tjera.

21 Për shembull, neni 402 i Kodit Penal përfundon se "krimet
22 mund të kryhen nëse kryesi e kërcënon rëndë që të sulmojë
23 drejtpërdrejt një person zyrtar kur kryen detyrat zyrtare".

24 Në lidhje me veprën penale sipas nenit 401(1), nëse, për
25 shembull, një kryes kërcënon anëtarin e familjes së një

1 personi zyrtar për të penguar këtë person zyrtar, atëherë ky
2 quhet kërcënim dhe është pjesë e pjesë e veprës penale. Po,
3 për shembull, mendoni sikur kryesi do të merrte dikë peng që
4 nuk është person i njohur për personin zyrtar. Në atë rast,
5 përsëri do të përmbushej detyrimi ligjor ose standardi ligjor
6 për sa kohë që personi zyrtar vendoset në një situatë ku ai
7 duhet të zgjedhë midis alternativës së kryerjes së detyrës apo
8 të shkaktimit të dëmit.

9 Në rastin konkret, duhet t'i jepet konsideratë të këtyre
10 sa më poshtë: së pari, domosdoshmëria e dëshmive të
11 dëshmitarëve për të kryer hetimet; së dyti, interesi i ZPS-së
12 dhe i DHSK-së dhe detyrimi i tyre ligjor për të mbrojtur
13 sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve; dhe, së treti, gama e
14 kërcënimeve që bënë të akuzuarit që ndikuan të gjithë ata që
15 bashkëpunojnë me autoritet; së katërti, natyra publike e
16 kërcënimeve që iu transmetua personave zyrtarë në ZPS dhe
17 DHSK. Këto kërcënime kishin për qëllim që të pengonin DHSK-në
18 dhe ZPS-së që të vazhdonin hetimet penale duke kërcënuar se
19 përndryshe siguria e dëshmitarëve dhe mirëqenia e tyre do të
20 ndikohej në mënyrë serioze dhe që dëshmitarët do të
21 dëmtoheshin.

22 Provat për të gjitha provojnë, pra, tej çdo dyshimi
23 përgjegjësinë e Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt sipas pikës
24 1 të Aktakuzës.

25 Për sa i përket pikës 2, provat tregojnë që gjatë

1 periudhës së Aktakuzës, të akuzuarit nuk kanë vepruar vetëm.
2 Ato bashkëpunuan me një numër personash të përbërë nga të
3 akuzuarit, Klinaku, Tom Gashi dhe të tjerë, përfshi edhe
4 anëtarë të tjerë të Organizatës së Veteranëve të Luftës,
5 veprimet e tyre të përbashkëta kanë penguar ose janë përpjekur
6 të pengojnë mandatin zyrtar të kësaj Gjykate.

7 Të akuzuarit dhe dëshmitarët kanë konfirmuar që një numër
8 i anëtarëve të OVL UÇK-së kanë bashkëpunuar në leximin e
9 këtyre paketave sapo janë dërguar. Vendimi për të thirrur
10 konferencat e shtypit është marrë kolektivisht në të tre
11 rastet. Faton Klinaku, Çelë Gashi dhe anëtarët e tjerë të
12 Organizatës së Veteranëve kanë dalë në tribunën e folësve në
13 tre konferencat e shtypit ngjitur me të akuzuarit.

14 Pas konferencës së parë të shtypit, është nxjerrë një
15 rezolutë e kryesisë së Organizatës së Veteranëve, duke thënë
16 se në qoftë se do të merreshin dokumente të tjera
17 konfidenciale ato do të botoheshin pa hezitim. Faton Klinaku
18 dhe Tom Gashi kanë dhënë deklarata publike të cilat kanë bërë
19 jehonë dhe kanë përforcuar, si të thuash, akuzat, kanosjen që
20 kanë bërë të akuzuarit dhe synimin e tyre kriminal.

21 Udhëheqja e UÇK-së ka vepruar si një grup i koordinuar
22 gjatë kohës së Aktakuzës. Prova ka treguar se në kapacitetin e
23 tyre si kryetar dhe nënkryetar i Organizatës së Veteranëve të
24 Luftës, Gucati dhe Haradinaj kanë koordinuar dhe organizuar
25 grupin për t'i ndër marrë këto veprime.

1 Një shembull i spikatur është i 8 shtatorit 2020, kur
2 asnjëri nuk ishte i pranishëm në Prishtinë dhe anëtarët e
3 tjerë të Organizatës së Veteranëve ranë dakord që të zbatonin
4 urdhrin e konfiskimit të Dhomave të Specializuara duke i dhënë
5 Klinakut autorizimin gojor përmes telefonit. Haradinaj u
6 informua më vonë. Haradinaj, më pas, ka luajtur një rol shumë
7 të shquar si një zëdhënës i Organizatës së Veteranëve të
8 Luftës së UÇK-së, duke i përçuar këto mesazhe kanosëse në
9 media.

10 Veprimi i përbashkët sipas nenit 401(2) të Kodit Penal të
11 Kosovës nuk ka ndonjë cilësues të veçantë, nuk ka nevojë për
12 një cilësim të veçantë. Kjo dispozitë nuk kufizohet vetëm në
13 rastet e veprimeve të përbashkëta për të përdorur forcën apo
14 kërcënimin për përdorimin e forcës. Madje as kanosja serioze
15 nuk është pjesë e kësaj dispozite. Pavarësisht, për sa i
16 përket çështjes që po shqyrtojmë sot, provat tregojnë që
17 veprimet e përbashkëta të të akuzuarit dhe të bashkëpunëtorëve
18 të tyre, në fakt, përbëjnë një kanosje serioze për të penguar
19 ose për t'u përpjekur për të penguar personat zyrtarë në
20 ushtrimin e detyrave të tyre. Provat kanë treguar që të
21 akuzuarit kanë qenë të ndërgjegjshëm dhe kanë dëshiruar që të
22 bashkëpunojnë si grup për të penguar personat zyrtarë në
23 ushtrimin e detyrave të tyre zyrtare.

24 Në një nga rastet kur Nasim Haradinaj ka inkurajuar
25 publikisht dorëzimin e dokumenteve të tjera konfidenciale dhe

1 ka kërcënuar se do të vazhdojë t'i publikojë materiale të
2 tilla, në një nga këto raste, Haradinaj tha se në qoftë se nuk
3 ishte ai, Faton Klinaku apo edhe zyrtari i nivelit më të ulët
4 të UÇK-së do të ishte i gatshëm që të bënte të njëjtën gjë. Të
5 akuzuarit ishin të ndërgjegjshëm se përmes kryerjes së grupeve
6 kriminale si grup, shtoheshin edhe gjasat e suksesit për ta
7 penguar punën e Gjykatës dhe këto gjasa shtoheshin në mënyrë
8 të ndjeshme.

9 Fushata e kanosjes nga të akuzuarit përfshinte më shumë
10 sesa tre persona dhe, në fakt, ishte një përpjekje e fuqishme
11 dhe e mirëllogaritur për t'ua mbyllur gojën të tërë atyre që
12 kanë bashkëpunuar apo dëshirojnë të bashkëpunonin me këtë
13 institucion me qëllim që personat zyrtarë të kësaj Gjykate të
14 pengoheshin në kryerjen e mandatit të tyre.

15 I nderuar Gjykatës, më është thënë që do të jemi gatshëm
16 që të vazhdojmë me variantin e korrigjuar të diapozituarit pas
17 pushimit.

18 Dhe unë do të përfundojë duke thënë që tërë provat e
19 paraqitura kanë provuar përgjegjësinë e të akuzuarve përtej
20 çdo dyshimi të arsyeshëm dhe kërkon dënimin në të gjitha pikat
21 e Aktakuzës. Siç do ta thotë kolegu im në pjesën e dytë të
22 fjalës mbyllëse të ZPS-së, përpjekjet e Mbrojtjes për të
23 provuar të kundërtën, në fakt, kanë pësuar dështime të plotë.

24 Faleminderit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

1 zonja Bolici.

2 Do të bëjmë pushimin e parë dhe do ta fillojmë seancën e
3 dytë në orën 11.30.

4 --- Pauza fillon në orën 10.57

5 --- Seanca rifillon në orën 11.30

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Uluni, ju
7 lutem.

8 Zoti Halling, një pyetje e thjeshtë. A dëshironi që ta
9 përfundoni fjalën tuaj brenda këtij sesi apo na duhet
10 tjetër.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Unë do të përpiqem që ta përfundoj
12 në këtë seancë, i nderuar Gjykatës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Dakord.
14 Kështu do të bëjmë. Do marrim pushim dhe pastaj do të kthehemi
15 për të bërë pyetje. Nuk besoj se do të ishte mirë ta fillonit
16 pak më vonë, por po të donit, dakord, por besoj se do të jetë
17 nesër.

18 Z. REES: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, mirë do të
19 ishte. Do të ishte më mirë nesër në mëngjes.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim] Po, ashtu
21 është më mirë.

22 Zoti Halling, ju e keni fjalën.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
24 Për pjesën që ka mbetur unë do të flas mbi përgjigjen e ZPS-së
25 lidhur me dosjen përfundimtare të ekipeve të Mbrojtjes që

1 është F00567 dhe 566 në këtë çështje. Do të fokusohemi në një
2 numër çështjesh të provës procedurale ligjore duke u përpjekur
3 që të mos përmendet çka janë thënë në mëngjes apo në
4 dokumentin tonë me shkrim. Në fund të fundit, prezantimi im do
5 t'i shërbejë gjykatësve të Trupit Gjykses. E di që të do të
6 dëshironin të bëni pyetje në fund. Në qoftë se dëshironi të
7 bëni pyetje gjatë kohës që unë flas, jeni më se të mirëpritur.

8 Përgjithësisht, dosjet përfundimtare të Gucatit dhe
9 Haradinajt nuk përfaqësojnë nivelin e përkujdesjes apo të
10 vëmendjes së të dosjeve të tilla që janë paraqitur para kësaj
11 Gjykate.

12 Mbrojtja e Gucatit e rezervon diskutimin në mbrojtjen e
13 kësaj seance të kësaj jave, pasi në fakt kjo dosje nuk ka
14 nxjerrë ndonjë përkuptim të ndryshëm sipas Rregullës 130. Nuk
15 ka asnjë mënyrë kuptimplotë për të trajtuar dëshminë dhe
16 kryesisht mbi pesë dëshmitarët që ata kanë sjellë këtu para
17 Trupit Gjykses.

18 Mbrojtja e Haradinajt në fakt bën disa pretendime të
19 çuditshme dhe gabime të ndjeshme për sa i përket provave, për
20 procesverbalin e provave. Në fakt, nuk ka këtu një avokati të
21 zellshme. Mbrojtja e Haradinajt nuk ka faj që e mbron në
22 mënyrë agresive klientin. Nuk po them atë. Por parashtrimet
23 tejet agresive duhet të jenë të mbështetura me prova, me
24 qëllim që të jenë kuptimplotë dhe ja çfarë shohim ne.

25 Nga paragrafi 432 i dosjes së fundit të Haradinajt, të

1 tëra procedurat janë të gabuara thelbësisht. Nuk janë në
2 përputhje me nenin 6 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të
3 Njeriut.

4 Nga paragrafi 489 qasja e ZPS-së te kjo çështje, e citoj,
5 është "kanosje për shtetin ligjor, kanosjen për besimin që
6 njerëzit kanë në institucionet e drejtësisë dhe është një
7 kanosje për demokracinë", përfundimi i citimit.

8 Në qoftë se dëshironi të flisni me këtë gjuhë, në qoftë
9 se doni të thoni që këto procedura janë të pabarabarta, që
10 Gjykatësit me kontrollin e tyre i janë kanosur Gjykatës
11 Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe demokracisë, në fakt
12 duhet të jepnin dëshmi për këtë dhe nuk e bëjnë dot një gjë të
13 tillë dhe unë do të flas në 90 minutat në vazhdim për të
14 provuar se për se nuk e provojnë dot ata.

15 Po e filloj me materialet e nxjerra. Çështjet e nxjerrjes
16 janë -- të gjitha janë bërë përmes vendimeve të Trupit
17 Gjykues, që ka bërë që disa materiale të nxirren e disa jo. Të
18 gjitha këto materiale janë bërë për të bërë që procedurat të
19 jenë të barabarta dhe jo siç thuhet në paragrafin 31 të dosjes
20 së Haradinajt, për të siguruar mjegullsi përmes miratimit të
21 hapur të Trupit Gjykues.

22 Fakti që Mbrojtja nuk hap -- nxjerrjen e duhur ose të
23 përshtatshme, siç thonë ata, siç pretendojnë ata në materialet
24 e tyre, kryesisht përmes -- dhe që nuk është në favorin e
25 tyre, kjo është një çështje e cila është në Rregullin 102(3)

1 për të cilën është kërkuar leje ZPS-së dhe kjo është në pjesën
2 F0041RED.

3 Trupi Gjykses nuk i ka marrë të gjitha faqet e dosjes 3,
4 apo të Paketës 3. Të gjithë informacionet që kanë të bëjnë me
5 dërgesën apo me shtytjen për të kryer një vepër penale, është
6 bërë përmes urdhrave për të thënë që Trupi Gjykses nuk e ka
7 bërë këtë, siç thuhet në faqen 431, është në fakt gabim. Është
8 gabim kur thuhet që Trupi Gjykses ka refuzuar. E drejta për të
9 konfrontuar provat e të akuzuarit, kundër paragrafit 241
10 [sipas përkthimit] të dokumentit të tyre, është bërë përmes
11 dokumenteve. Trupi Gjykses ka vendosur që të gjitha këto të
12 diskutohen hollësisht dhe një numër dokumentesh nuk janë
13 pranuar dhe kjo nuk do të thotë që nuk ka pasur një
14 konfrontim, si të thuash.

15 Megjithatë, të gjitha provat e pranuar përmbushin të
16 drejtat e të akuzuarit. Të vazhdohet të argumentohet në këtë
17 dosje që Mbrojtja nuk ka qenë në gjendje që të kundërshtojë
18 provat, në fakt injoron atë që ka ndodhur gjatë kësaj kohe dhe
19 kjo nuk është çështje e nxjerrjes, të nderuar Gjykatës.

20 Këtu ka ndikim edhe mbi vendimet lidhur me provat. ZPS-ja
21 sipas tyre ka arritur që të pranojë materialet krejt "të
22 papranueshme". Megjithatë të akuzuarit e argumentojnë në
23 paragrafin 256 e 257 të dosjes së Haradinajt, që karakterizon
24 atë faktin që sipas tyre është dhunuar barazia gjatë këtyre
25 procedurave.

1 Të kthehemi pak pas për të thënë se çfarë ka ndodhur për
2 sa i përket këtyre dy dëshmitarëve. Janë dy dëshmitarët e
3 Haradinajt, të cilët janë paraqitur për këtë pjesën e
4 korrupsionit të EULEX-it. Ato janë hedhur poshtë nga Trupi
5 Gjykues me një vendim të arsyetuar. Janë lejuar *proprio motu*
6 për të apeluar dhe këto vendime janë konfirmuar në apel. Kjo
7 është vijueshmëria e ngjarjeve të cilat janë në -- ata thonë
8 që kanë dhunuar barazinë.

9 Për sa i përket kanosjes, klimës së frikësimit, është
10 ngritur një ankesë për dëshmitarin Robert Reid, sipas
11 Rregullës 143(3) dhe mund të shikoni këtu që pala Mbrojtëse
12 është fokusuar në atë pjesë të rregullës e cila e kufizon
13 kundërpyetjen dhe në faqen 3311 të transkriptimit edhe aty
14 Gjykatësi i kërkoi Mbrojtjes së Haradinajt që ka një pjesë të
15 dytë të Rregullës për këtë çështje dhe shihet në paragrafin 7
16 të dosjes së Haradinajt, thuhet që kjo "pyetje *prima facie*
17 është në bazë të Rregullës 143(3)" dhe atë në mënyrë selektive
18 përzgjedhëse, e citojnë këtë Rregull në fakt që fjalia e dytë
19 është atje. Është një angazhim për një realitet alternativ për
20 të thënë që nuk ka ndodhur ajo që ka ndodhur në të vërtetë në
21 këtë gjyq. Dhe ajo që ka ndodhur është që është provuar
22 fajësia e të akuzuarve, ndërkohë që palët mbrojtëse po
23 diskutojnë mbi diçka tjetër që nuk ka ndodhur.

24 E kjo shihet në mënyrën se si dosjet e palës Mbrojtëse
25 bazohen shumë në dëshmitë e pa pranuar. Siç e dini ju, të

1 nderuar Gjykatës, Rregulli 139(1) i Rregullores kërkon që
2 Trupi Gjykues të shqyrtojë vetëm materialet e pranuar si
3 prova materiale për nxjerrjen e vendimit të tyre. Në
4 paragrafin 98 të dosjes së Haradinajt, aty thuhet që
5 dëshmitari e ka pasur të qartë që njerëzit duhet të
6 bashkëpunonin me DHSK-në dhe me ZPS-në. Është një dokument i
7 vetëm i cituar me të tërë këtë program. Është një deklaratë e
8 vitit 2019, është përpara periudhës së akuzave. Është një
9 deklaratë e Gjykatësit, -- e Gucatit dhe të bashkëakuzuarit. E
10 njëjta gjë edhe në paragrafin 385. Punonjësi i ZPS-së, i cili
11 ka shkruar që Haradinaj u ka thënë dëshmitarëve që të mos
12 përmendnin emra, kjo është një notë zyrtare, e cila është
13 paraqitur për t'u pranuar por është gjykuar se është e
14 papranueshme. Megjithatë ato mbështeten me këtë përsëri.

15 Pyetjet e Mbrojtjes nuk janë provë. Provë janë vetëm
16 përgjigjet që japin dëshmitarët dhe nuk ka, për shembull,
17 asnjë dëshmi që të thotë që 25 pjesëtarët e ZPS-së të jenë të
18 pushuar nga puna për shkak të këtyre dërgesave, por kjo nuk e
19 ndalon Mbrojtjen e Haradinajt për ta paraqitur këtë në
20 paragrafin 27 të dosjes së saj.

21 Shembull tjetër është -- të parashtrimeve të Mbrojtjes që
22 paraqitin si dëshmi është lista e emrave që është dhënë për
23 dëshminë e znj. Pumper dhe ky është rasti kur ka të bëjë me
24 dëshmitarët potencial dhe ky karakterizim nuk është i
25 pranueshëm. Kjo nuk është provë e pranuar dhe nuk mund të dalë

1 nga provat apo nga dëshmia e paraqitur para Trupit Gjykses.

2 Në paragrafin 319 të dosjes së Haradinajt thuhet që një
3 dëshmitar shqiptar mendohet që është angazhuar për çështje të
4 cilat kanë të bëjnë me mandatin e TFHS-së. Kjo bazohet në një
5 artikull mediatik që është ofruar nga Mbrojtja e Gucatit dhe
6 që u deklarua e papranueshme nga Trupi Gjykses dhe kjo jepet
7 në vendimin me numrin e protokolluar F00502 në paragrafin 36 -
8 39.

9 Oficeri i ZPS-së pretendon gabimisht që të jetë i
10 implikuar në paketat, gjë e cila është objekt i pyetjeve sa i
11 takon pyetjeve të znj. Pumper dhe Jukiç. Dhe ndërkohë pyetjet
12 kishin të bënin me një njoftim zyrtar për sa i takon një
13 çështjeje e cila thuhet që nuk kishte fare të bënte me asnjë
14 njohuri tjetër përveç asaj çfarë përmbante njoftimi dhe kjo do
15 të thotë që është njoftimi dhe intervista që përkojnë me këtë
16 shënim zyrtar që është vetëm baza për pretendimin që dëshmia e
17 dy stafeve të ZPS-së ishte e gabuar, ndërkohë që as njoftimi
18 dhe as intervista në vetvete nuk janë ofruar si prova.
19 Megjithatë kjo nuk e ka ndaluar Mbrojtjen e zotit Gucati që të
20 mbështetet në indicie për shtytjen në krim.

21 Ka raste kur Mbrojtja as nuk mundohet fare që të
22 referohet në ndonjë provë të prekshme siç janë për shembull
23 teoritë e konspiracionit që kanë të bëjnë me paragrafët 22 -
24 26 për sa i takon shërbimeve të huaja të inteligjencës. Dhe
25 gjithsesi leximi është interesant dhe kjo nënkupton se si këto

1 dosjet dhe paketat e marra shkojnë përtej fushës së veprimit
2 të kësaj çështjeje. Ajo çfarë ka bërë ZPS-ja në këtë rast
3 është që ka marrë këtë pjesë të një hetimi më të gjerë dhe ka
4 akuzuar të akuzuarit, ka ngritur akuza kundër të akuzuarit
5 brenda kësaj fushe.

6 Dhe ndërkohë realiteti fals është përsëritur në mënyrë të
7 vazhdueshme në këto dosje paraprake. Kjo është e vërtetë kur
8 rishikohen argumentet e Mbrojtjes dhe informacionet që kanë
9 ato. Këtë në fakt mund ta shikojmë edhe në momentin kur
10 diskutohet besueshmëria e Miro Jukiç.

11 Ka shumë aspekte të dëshmisë së dhënë nga zoti Jukiç të
12 cilat janë kundërshtuar dhe sulmuar nga Mbrojtja e Haradinajt
13 dhe ndërkohë që do të cekin disa prej këtyre elementëve dhe në
14 qoftë se Trupi Gjykses ka pyetje, ju lutem na i bëni ato.

15 Atëherë do të fillojmë me pikën e parë: mungesa e zyrës
16 në Prishtinë. Parashikohet, pretendohet në paragrafin 136,
17 thuhet që ZPS-ja nuk ka zyrë në Prishtinë.

18 Kjo është një çështje besueshmërie, duke marrë parasysh
19 provat e zotit Moberg. Ndërkohë, konteksti për përgjigjen
20 duhet që të vlerësohet atëherë kur bëhet vlerësimi i
21 argumentit të Mbrojtjes. Këtu konteksti vjen nga faqet 1776 -
22 1777 të transkriptimit dhe ajo çfarë thotë Jukiçi është që nuk
23 ka një zyrë permanente, të përhershme të ZPS-së në Prishtinë.
24 Dhe përgjigja vjen në kuadrin e diskutimit të oficerëve të
25 ZPS-së dhe pasjes së një rrotacioni ose një ndryshim të tyre -

1 - dhe ndërkohë kjo është në përputhje me dëshminë e Mobergut
2 dhe kjo nuk do të thotë që ZPS-ja nuk ka asnjë zyrë në
3 Prishtinë.

4 Pra duket sikur në shumë mospajtimi, mospërputhja, mund
5 të jetë teknike më shumë se sa e kuptimtë. Dhe meqenëse se ra
6 fjala, prania ose mungesa e zyrës së ZPS-së në Prishtinë nuk
7 është fakt me interes për këtë çështje. Dhe në fakt është një
8 gjë e çuditshme për të gënjyer, se pse duhet një person i
9 ekipit të sigurisë së dëshmitarëve të ZPS-së të thotë një gjë
10 lidhur me praninë e zyrave të ZPS-së, e cila nuk është e
11 vërtetë. Në shumë raste të dëshmitarëve, dhe kjo është diçka
12 në fakt që reflektohet në paragrafin 146 deri 250 [sipas
13 përkthimit] të dosjes së Haradinaj, paragrafi 241 po ashtu.
14 Zoti Jukiç nuk u fut në shumicën e dëshmitarëve, por në fakt
15 ka folur vetëm me pak prej tyre. Ai flet rreth gjërave të
16 ndryshme çdo herë dhe ajo çfarë ngre Mbrojtja në fakt ka të
17 bëjë me ekspozimin e argumentit dhe me bërjen e dallimit
18 ndërmjet cilësisë së dëshmitarëve më shumë se sa çështje e
19 besueshmërisë së tij.

20 Z. Jukiç pyetet dy herë lidhur me dëshminë. Herën e parë
21 është në faqen 1761 - 1762 të transkriptimit dhe Gjykatësi
22 Barthe pyet dëshmitarin dhe pyetjet jepen njëra pas tjetrës.
23 Pra, sa dëshmitarë janë kërcënuar dhe përgjigja që jepet është
24 që pjesa më e madhe prej tyre kanë problemet të cilat lidhen
25 me sigurinë. Kjo është një pyetje e cila ose këto pyetje janë

1 trajtuar gjithashtu edhe nga z. Reese dhe kjo reflektohet në
2 faqen 1834 të transkriptimit, ndërkohë që pyetjet nuk janë
3 sipas radhës. Pra janë të bëra lëmsh dhe në qoftë se do të
4 lexohen dy shkëmbimet: atë të dytën dhe të parën, pra duket
5 sikur z. Jukiç po flet rreth tre kategorive të cilat ai i ka
6 specifikuar më parë gjatë marrjes së tij në pyetje nga Trupi
7 Gjykues.

8 Pra me fjalë të tjera, bëhet fjalë vetëm thjeshtë me një
9 përpjekje të qëllimshme për të pretenduar që pozicioni i ZPS-
10 së është shumë herë më i keq se sa pretendohet fillimisht që
11 të ishte.

12 Të gjithë dëshmitarët janë të frikësuar ose të mërzitur.
13 Kjo paraqitet në paragrafin 242 [sipas përkthimit] të dosjes
14 së Haradinajt. Është e qartë që jo të gjithë dëshmitarët në
15 fakt janë të frikësuar ose të zemëruar. Të nderuar Gjykatës,
16 ju mund ta nxirrni këtë nga transkriptimet.

17 Sigurisht që konteksti se ku janë marrë përgjigjet është
18 shumë e rëndësishme. Ndërkohë lidhur me z. Jukiç, ai është
19 pyetur lidhur me dëshmitarët që ka kontaktuar ai. Kjo është e
20 qartë në faqen 1881 deri në 1882 të transkriptimit. Shënimet e
21 kontaktit si ato të ZPS-së, të cilat kanë të bëjnë me
22 dëshmitarët, nuk janë dokumente në të cilat ai është
23 mbështetur. Sa i takon Mbrojtjes së Gucatit, Mbrojtja e z.
24 Gucati iu drejtua z. Jukiç lidhur me 37 dëshmitarët apo 77
25 dëshmitarët. Dhe me të thënë të drejtë, këto shifra jo vetëm

1 nuk janë vendosur në kontekstin e caktuar, duke sugjeruar se
2 si 37 dëshmitarët, dhe 77 dëshmitarët janë grupe dëshmitarësh
3 të cilët nuk kishin shqetësime. Pra fakte të rëna dakord janë
4 propozuar, ndërkohë që për këto fakte nuk është rënë dakord.
5 ZPS-ja nuk pranon që këto statistika janë përfaqësime
6 mirëkuptimi i këtyre shënimeve dhe pjesa dërmuese e këtyre
7 shënimeve janë pranuar në prova dhe kjo në vetvete nuk
8 reflekton pozicionin që ju Jukiç nuk i dinte këto numra. Por
9 këto janë shifra që thjesht nuk janë të mbështetura në prova
10 që dëshmitari nuk dinte lidhur me të.

11 Aktakuza nuk kërkon pragje specifike, konkrete, sasiore
12 sa i takon dëshmitarëve. Jukiçi nuk tha asnjëherë, nuk ka
13 pretenduar asnjëherë që ka thënë statistika të sakta lidhur me
14 dëshmitarët dhe nuk kemi asnjë lloj ploti të qartë që ai
15 kishte si qëllim që ta bënte një gjë të tillë, siç mendohet,
16 apo siç argumentohet në paragrafin 372 të dosjes së
17 Haradinajt. Ai në fakt dha një bazë faktike të gjërave të
18 cilat ai kishte mësuar ai vetë personalisht dhe gjëra të cilat
19 i kishte mësuar nga të tjerët. Në një çështje ku një dëshmitar
20 i prekur mjafton për të dhënë dënimin për të gjitha pikat,
21 deklarata e dhënë nga dëshmitari Jukiç është më se e
22 mjaftueshme për qëllime për të cilat është pranuar dhënia e
23 dëshmisë së tij. Po ashtu edhe informacioni që ka dhënë zoti
24 Jukiç, pra indicet, të cilat ka përmendur zotit Jukiç, është e
25 besueshme, sepse ai reflekton gjendjen ose le të themi

1 situatën mendore të dëshmitarëve menjëherë pas akuzave.

2 Pra, në këtë segment Jukiç jep dëshmi që janë në
3 përputhje me shënimet që kanë marrë nga dëshmitarët. Janë
4 gjithashtu në përputhje me dëshmitë e zonjës Pumper, me klimën
5 e frikësimit në Kosovë dhe me situatën e përgjithshme se si do
6 të reagoje një dëshmitar në qoftë se do të mësonte që
7 informacioni i tyre konfidencial do të bëhej publik. Pra është
8 një kuptim i cili dhe një situatë e cila pranohet edhe nga
9 vetë të akuzuarit.

10 Ju e mbani mend shkëmbimin, besoj, të zotit Haradinaj
11 lidhur me përmbledhjen paraprake ku ai thotë që në qoftë se
12 informacioni do të nxirret, do të shkaktonte vdekjen ose
13 frikësimin e tyre deri në vdekje, për shkak të faktit që ata
14 ishin dëshmitarë të mbrojtur. Kur e kam pyetur për herë të
15 parë z. Haradijan rreth kësaj gjëje, ai e pranoi se e kishte
16 thënë këtë gjë. Pra fakti që ai e ka thënë këtë gjë, në
17 vetvete është domethënës. Ai tha që këtë gjë e ka marrë vesh,
18 e ka dëgjuar paraprakisht nga media por pretendon gjithashtu
19 që edhe ai vetë e pretendon apo e mendon këtë informacion si
20 të vërtetë.

21 Le të shohim pak segmentin përkatës.

22 [Luhet videoincizimi]

23 "Z. Halling:

24 "Py. Pra në fragmentin ju flisni që dëshmitarët janë të

1 frikësuar për vdekje. A është një qëndrim ky me të cilin apo
2 një opinion publik me të cilin ju pajtoheni?

3 "Pë. Kush nuk do të pajtohej me këtë që nuk do të ishte e
4 vërtetë? Në qoftë se diçka është e vërtetë nuk ka asgjë për
5 t'u pajtuar këtu. Nuk ka asgjë për të mos u pajtuar. Sepse në
6 qoftë se njerëzit janë pengesë për drejtësinë, zoti Prokuror,
7 unë në fakt jam i gjithi në favor të drejtësisë."

8 Z. HALLING: [Përkthim] Në të vërtetë në fakt kush nuk bie
9 dakord që kjo nuk është e vërtetë. Domethënë ai pranon që kjo
10 është e vërtetë.

11 Ndërkohë, Mbrojtja e zotit Gucati kur dha dëshminë,
12 Mbrojtja e Gucatit tha të njëjtën gjë.

13 Të nderuar Gjykatës, juve pyetët korrigjimin, ju kërkuat
14 diapozitivën e korrigjuar, që është e rëndësishme dhe me vend
15 në këtë temë dhe dua t'ju them që edhe në qoftë se do të
16 shikojmë pjesën e gjuhës së përdorur:

17 "Dhe po ju them juve përsëri se në qoftë se një emër do
18 të ishte nxjerrë nga unë nga kryesia e OVL-së së UÇK-së,
19 sigurisht që ato do të kishin dëmtuar dëshmitarët dhe ne do të
20 kishim nxjerrë gjëra të tilla".

21 "Sigurisht domethënë që personat do të ishin ndjerë të
22 frikësuar".

23 Të nderuar Gjykatës, në këtë dosje përfundimtare nuk ka
24 asgjë që justifikon mosmbështetshmërinë e dëshmisë së dhënë

1 nga zoti Jukiç.

2 Shtrembërimet vazhdojnë më tej a i takon diskutimeve të
3 ligjit të procedurës dhe sa i takon edhe parimeve provuese në
4 dosjen përfundimtare, veçanërisht do të fillojmë me
5 keqpërfaqësimin e parimeve të interpretimit ligjor.

6 Zonja Bolici u përqendrua te parimi i ndërtimit strikt
7 dhe thjesht për ta thënë këtë gjë, ambiguiteti dhe ndërtimet
8 strikte në favor të të pandehurit është diçka e cila zbatohet
9 atëherë kur parimet standarde ligjore nuk mund të jenë të
10 mbështetura ose nuk qëndrojnë. Pra domethënë duhet që të
11 zbatohen standardet ligjore së pari, përpara se të kalohet tek
12 alternativat e tjera. Çdo mosmarrëveshje ka të bëjë -- pra
13 duhet që të bëhet interpretimi i duhur të ligjit, sepse në të
14 kundërtën do të kishim të bënim vetëm thjesht me një çështje
15 preference.

16 Ne mund ta shikojmë zbatimin korrekt të këtij parimi në
17 vendimin e apelit të TPNJ-së në Milutinoviç kundër të gjithë -
18 - e të tjerë, që ka të bëjë me juridiksionin e ndërmarrjes së
19 kriminalit të përbashkët. Është vendim i cili është marrë me
20 21 maj të vitit 2003, paragrafi 27 dhe 28.

21 Pra Gjykatësi i ofrohet një tjetër rregulli që është një
22 tjetër mënyrë e këtij parimi. Pra, është një tjetër emërtim i
23 parimit që unë sapo citova por në fakt duket që ky është
24 rregull i cili mund të zbatohet vetëm atëherë kur aplikimi i
25 rregullave statutore apo ligjore nuk mund të justifikohen. Kjo

1 jepet në paragrafin 438 të Vendimit të Mbrojtjes dhe jepet
2 gjithashtu në dokumentacionin përkatës.

3 Por kjo nuk është mënyra se si aplikohen parimet në
4 dosjen e Gucatit. Në paragrafin 15, kur flasim për leximin e
5 kërkesës për pengesën për të detyruar në kuadrin e pikës 1,
6 për pengimin e proceseve gjyqësore, pra në paragrafin 15
7 parashikohet në qoftë se ligjvënësi e ka hequr këtë paragraf,
8 kjo nuk ka vlerë sepse DHSK-ja kërkon që çdo paqartësi të mund
9 të hiqet në favor të Mbrojtjes. Por kjo nuk mund të bëhet. Pra
10 parimet standarde të interpretimit ligjor nuk kërkojnë
11 elementë të forcës që të lidhet me pikën 1 të Aktakuzës. Pra
12 ka interpretime të ndryshme ligjore, ndërkohë që ka terma të
13 ndryshme të cilat përdoren.

14 Por megjithatë kemi atë çfarë quhet kanuni i çështjes së
15 hequr, çfarë do të thotë që asgjë nuk duhet të shtohet plus
16 asaj që çfarë deklarohej nga teksti ose që implikohet në
17 mënyrë të arsyeshme.

18 Dhe ky është një shembull klasik për sa i takon
19 mosrespektimit të këtij parimi. Pra fjala "forcë" lexohet në
20 një dispozitë në të cilën kjo fjalë nuk ekziston aspak,
21 ndërkohë që kjo fjalë në fakt është përdorur gjetkë në kod dhe
22 është hequr në një version të mëparshëm të Kodit Penal.

23 E njëjta gjë është e vërtetë edhe për pikën e dytë në
24 paragrafin 27 të dosjes së Gucatit, dhe këtë në fakt e
25 shikojmë edhe lidhur me pikën 6. Në qoftë se do të shikojmë

1 paragrafët 81 dhe 82 të dosjes së Gucatit, në të flitet se si
2 pika 6 përmban kërkesën që nuk ka prova që materiali relevant
3 të nxirret për të akuzuarin në procedurat penale. Ky formulim
4 është qartësisht në gjurmim të gjuhës ligjore, por gjurmon në
5 fakt gjuhën ligjore të pikës 5. Atëherë, pavarësisht se çfarë
6 nënkuptojmë me këtë fjalë, ato nuk të kalojnë, nuk mund të
7 zhvendosen në një dispozitë ku nuk përmenden fare këto fjalë.

8 E kundërta ndodh gjithashtu edhe në dosje ku gjuha e
9 dispozitave ligjore injorohet fare nga Mbrojtja e Haradinajt.
10 Për shembull, në paragrafin 81 ku flitet për pengim dhe sipas
11 kësaj dosjeje thuhet që nuk ka të dhëna që ka pasur pengim të
12 një zyrtari nga kryerja e detyrave të veta zyrtare. Një
13 rezultat i saj është një pengesë në dispozitën ligjore, por
14 dispozita vazhdon dhe thotë që kemi -- domethënë, ndërkohë që
15 në Mbrojtjen e Haradinajt përmendet e para, por ndërkohë e
16 dyta nuk përmendet. Dhe kemi pra një interpretim selektiv
17 sipas dëshirës së Mbrojtjes.

18 Së fundi, presumimi kundër pa efektivitetit, mungesës së
19 efektivitetit, është një interpretim ligjor, pra thuhet që
20 kemi të bëjmë me një interpretim të lejueshëm tekstual që më
21 tej pengon qëllimin e dokumentit për të qenë i favorshëm.

22 Ndërkohë në paragrafin 51 të dosjes së Gucatit flitet për
23 kërcënimin që është i kufizuar vetëm tek ato procese të cilat
24 bien nën nenin përkatës që është neni 361 i Kodit Penal.
25 Ndërkohë që ky lexim është absolutisht shumë i ngurtë dhe i

1 ngushtë. Ndërkohë që titulli i nenit 387 i Kodit Penal të
2 Kosovës e ka titullin "Kërcënimi gjatë procedurave penale".
3 Pse kjo dispozitë duhej që të përqendrohej në një pjesë të
4 ngushtë le të themi, nën këtë nen.

5 Dhe për këtë arsye është e rëndësishme që të jepet një
6 fushë veprimi më e gjerë në nenin 387. Neni 387 i Kodit flet
7 për pengesën e provave ose të procedurave zyrtare. Në të
8 flitet për procedurat të cilat nuk janë domosdoshmërisht
9 procedura penale por në të flitet për procedura të cilat janë
10 për vepra të vogla, procedura administrative, procedura të
11 tjera. Pra me fjalë të tjera, bëhet fjalë për një fushë goxha
12 më të gjerë të procedurave të tilla. Megjithatë, në kuadrin
13 specifik të procedurave penale, është theksuar interesi i
14 mbrojtur dhe kjo në fakt mund të shihet në gjuhën që përdoret,
15 në kërcënimet serioze, përdorimin e forcës, etj. Dhe kjo është
16 mënyra se si kuptohen të ndërlidhura këto dispozita me njëra
17 tjetrën. Në qoftë se interpretimi i Gucatit është i saktë,
18 atëherë do të ishte e pamundur që të gjendet raste, lëndë në
19 Kosovë ku njerëzit janë dënuar për kërcënim dëshmitarësh, me
20 ndonjë arsye tjetër të ndryshme nga pengesa që parashikohet
21 nga neni 368 i versionit të kodit penal tani.

22 Por fakti është që ka raste të kësaj natyre dhe ndërkohë
23 tani do t'ju dëshmoj dy çështje të tilla. Në Gjykatën
24 Themelore të Ferizajt, në çështjen PKR 36-19, 2019:080214, të
25 datës 10 qershor të vitit 2020. Është një vendim fajësie për

1 frikësim dhe përdor fjalët identike që përdoren në kodin e
2 vitit 2012, që është neni 395. Tani pengimi është Neni 36,
3 përpara ka qenë 394 dhe ky ishte frikësim në lidhje me një
4 incident shtënie me armë. Një dëshmitar në një shkëmbim
5 zjarri, në një restorant dhe ai po ndiqej për akuzën se ka
6 përdorur armë, apo një instrument të rrezikshëm, sipas nenit
7 375.

8 Në Gjykatën Themelore është çështja 2021:013216 i datës 12
9 shkurt të vitit 2021. Përsëri është vendim fajësie për
10 frikësimin e një personi në rastin e një ngacmimi. Kjo bie nën
11 nenin 186 të Kodit Penal të Kosovës.

12 Pra Mbrojtja e Gucatit e ka interpretuar shumë ngushtë
13 këtë dispozitë dhe ekziston një interpretim më i natyrshëm i
14 kësaj dispozite, që është mënyra se si e interpreton Gjykata.
15 Pra, interpretimi i tyre ligjor për pikën tre nuk funksionon.

16 Për sa i përket parimeve të provave dhe duke ngritur
17 kriteret për vërtetimin ose bashkë-vërtetimin që nuk ekziston.
18 Provat më të rëndësishme të Prokurorisë janë materialet
19 audiovizuale. Ne e kemi thënë që në fillim dhe e themi edhe
20 sot, numërimi se sa dëshmitarë janë për një përcaktim të
21 caktuar, e keqinterpreton natyrën e kësaj çështjeje dhe këto
22 argumente po kështu injorojnë, ashtu siç tha edhe zonja Bolici
23 në mëngjes, injorojnë gamën e gjerë të dëshmitarëve të
24 Mbrojtjes, përfshirë të akuzuarit, që dhanë dëshmi
25 inkriminuese të mëtejshme.

1 Nuk ka kërkesë të përgjithshme për vërtetim që çdo fakt
2 të ketë një kombinim të provave të tjera të dëshmimeve apo
3 dokumentare shkresore, që të jenë të vlefshme. Provat tona
4 materiale nuk janë të dëgjura nga palët të treta por janë
5 pranime nga palët. Në një argument që lidhet me këtë, Mbrojtja
6 e Haradinajt thotë që këto paketa nuk mund të shërbejnë si
7 prova sepse nuk ka kronologji apo zinxhir të mbajtjes në
8 mbrojtje të dokumenteve që të jetë dhënë, që e ka kërkuar
9 Mbrojtja e Haradinajt. Por ka plotë prova që vërtetojnë
10 autenticitetin e këtyre dokumenteve, dorëzimin e dokumenteve,
11 dëshmitë e dëshmitarëve, artikujt e gazetave, faqet e vetë
12 paketave, ka edhe disa tabela nga zonja Pumper, të cilat i
13 përshkruajnë kaq mirë këto prova, shumë më mirë se sa çdo
14 dokument nga OVL UÇK-ja.

15 Mbrojtja e Haradinajt nuk mund të privilegjojë disa prova
16 mbi disa të tjera, në këtë kontekst. Ato duhet të merren të
17 gjitha së bashku.

18 Është e qartë nga argumentet e Mbrojtjes së Haradinajt,
19 nuk do të ketë asnjë zinxhir të mbajtjes në ruajtje të
20 dokumenteve që do t'i kënaqte ata. Këtë mund ta shikoni edhe
21 në dosjen e tyre, ku ata argumentojnë se Paketa 1 nuk ka një
22 evidencë të mbajtjes në ruajtje. Megjithëse dëshmitarja e ZPS-
23 së erdhi këtu dhe iu përgjigj të gjitha pyetjeve se si u
24 përgatit kjo Paketë.

25 Për sa përket anës procedurale dhe për kërkesat për

1 rishqyrtimin e Aktakuzës në këtë rast, pika që ka të bëjë me
2 mocionet është që çështjet procedurale ta ushtrojnë trysni mbi
3 procesin përpara se sa të fillojë. Janë ngritur këtu çështje
4 për defekte në formën e Aktakuzës. Ato u zgjidhën nga
5 Gjykatësi i Procedurës paraprake dhe po kështu u mor vendim
6 për to edhe në procesin e apelit.

7 Mbrojtja argumenton në lidhje me këto -- argumentet që
8 ngriti Mbrojtja në lidhje me këto duhej të ishin bërë që në
9 fillim dhe nuk ka dokumente në dosjen e tyre përfundimtare në
10 lidhje me mënyrën se si janë zhvilluar procedurat gjyqësore.

11 Të nderuar Gjykatës, ju tërheq vëmendjen në vendimin e
12 TPNJ-së në çështjen Karaxhiç. Ky është vendim në lidhje me
13 defekte në formën e aktakuzës më 30 shtator të vitit 2014. Në
14 këtë kontekst ata e hodhën poshtë kërkesën për konstatim
15 defekti në Aktakuzë. Trupi Gjykues e kundërshtoi ose e hodhi
16 poshtë këtë kundërshtim të Mbrojtjes kur tha se këto
17 kundërshtime për defekte në Aktakuzë nuk janë bërë në kohën e
18 duhur dhe i takon tani të akuzuarit që të vërtetojë këtë.

19 Mbrojtja këtu nuk ka vërtetuar këtë.

20 Pra kur Mbrojtja e Haradinajt argumenton se në pikën 5 të
21 Aktakuzës dëshmitarët duhet të identifikoheshin, kjo u
22 kundërshtua si defekt i aktakuzës. Gjykatësi i Procedurës
23 Paraprake e hodhi poshtë këtë kundërshtim dhe megjithëse
24 Mbrojtja donte ta hidhte në apel këtë çështje në lidhje me
25 identifikimin e bashkëfajtorëve, apo bashkëkryerësve, ata nuk

1 kërkuan apel për identifikimin e dëshmitarëve që përmenden në
2 aktakuzë. Në paragrafin 67 to dosjes së Gucatit, ndryshe nga
3 çfarë argumenton Gucati, apo sugjeron, ajo nuk është në mënyrë
4 specifike vetëm për informacion sekret. Ka dy pjesë pika 5 e
5 aktakuzës që përqendrohen në këtë pikë, të cilat nuk duhet të
6 zbulohen sipas ligjit ose që janë deklaruar se janë sekret me
7 një vendim të Gjykatës. Kur ZPS-ja flet për informacion sekret
8 e ka fjalën për të dyja këto kategori dhe kjo kuptohet qartë
9 në vendimin e konfirmimit që pengon të dy alternativat dhe në
10 qoftë se Mbrojtja e Gucatit konsideron se kjo ishte e paqartë
11 apo e mjegullt, i takon atyre që të kërkonin rishikim të
12 aktakuzës në lidhje me këtë.

13 Të akuzuarit thotë -- dosja e Haradinajt thotë që të
14 akuzuarit nuk janë akuzuar me frikësimin e mediave, ata janë
15 akuzuar për përdorimin e kërcënimeve serioze për të nxitur apo
16 për të shtyrë dëshmitarët në një drejtim të caktuar. Siç
17 shihet qartë në paragrafët 4 dhe 29 të aktakuzës. Mbrojtja e
18 Haradinajt flet në mënyrë të vazhdueshme për mënyrën se si
19 janë bërë këto veprime nga ZPS-ja.

20 Kjo praktikë është mjaft e zakonshme. Është në përputhje
21 me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në rastin
22 e Gjykatës Evropiane përmend rastin e Karaman kundër
23 Gjermanisë, që është numri i kërkesës referuese, 27 shkurt
24 2014, paragrafi 16 [sipas përkthimit], për lejueshmërinë e
25 ngritjes së akuzave në lidhje me këtë pikë.

1 Në një pikë të fundit, vendimet e fajësisë alternative
2 dhe përmbledhëse, Mbrojtja e Gucatit është konfuze në këtë
3 drejtim. Do të përpiqem t'i sqaroj.

4 Së pari, ajo që argumentohet në paragrafin 142 të Gucatit
5 është e gabuar. ZPS-ja nuk ka kërkuar dënime alternative në
6 këtë rast. Ne po kërkojmë vendime fajësie përmbledhëse për
7 krimet e kryera në përputhje me elementët e materialitetit dhe
8 Mbrojtja e Gucatit pajtohet se është zbatuar standardi i duhur
9 në paragrafin 137 [sipas përkthimit].

10 Ne kërkojmë konstatime për të gjitha format e
11 përgjegjësisë alternative por vendimi i fajësisë do të jepet
12 vetëm për një prej tyre. Pra duhet të shprehet e gjithë gama e
13 fajësisë.

14 Pra, kur thotë Mbrojtja e Gucatit se Pika 2 është një
15 formë e rënduar e Pikës 1, apo që është dytësorë ndaj Pikës 1,
16 siç e thonë në paragrafin 30 dhe 146 të dosjes së tyre, ata e
17 keqzbatojnë standardin e elementëve të veçantë që kanë rëndësi
18 materiale të veçantë dhe Trupi Gjykses mund të japë vendime
19 fajësie për të dyja.

20 Për sa i përket çështjes ose provave të paraqitura nga
21 Mbrojtja, për shtytjen e për kryerje të veprës penale. Ajo
22 tani nuk është e përfshirë në dosje si një mbrojtje
23 afirmative. Tani ajo jepet si një shkelje e të drejtës për
24 gjykim të drejtë. duke thënë vazhdimisht se këto procedura
25 abuzojnë procesin, është një mjet ligjor ekstrem. Ai duhet të

1 zbatohet kur janë bërë shkelje kaq të mëdha të të drejtave të
2 të akuzuarve, sa që është e pamundur të bëhet gjykimi i drejtë
3 i tyre, dhe Mbrojtja nuk ju jep ju asnjë autoritet në lidhje -
4 - domethënë në një precedent tjetër gjyqësor në lidhje me këto
5 ndalime të procedurave apo mbyllje të gjykimeve. Ka një rast
6 nga Lubjana [sipas përkthimit] në Gjykatën Ndërkombëtare të
7 Drejtësisë, me numër ICC-01/04-01/06-772 dhe ICC-01/04-01/06-
8 1486.

9 Nuk ka shkelje të të drejtave të të akuzuarve për gjykim
10 të drejtë dhe as shkelje kaq të madhe sa që të ndalohet
11 gjykimi. Edhe kur ka aplikime për shkelje të të drejtave
12 themelore të njeriut edhe në qafoftë se ka, këto duhen ngritur
13 në mënyrën e duhur dhe në kohën e duhur dhe kjo nuk është
14 bërë.

15 Kjo është hera e parë që ngrihet kjo kërkesë për këtë
16 masë ligjore. Nuk është kërkuar më përpara. Në bankën e të
17 dhënave për çështjet gjyqësore të GJPN-së ka një çështje.
18 Është çështja Katanga, ICC-01/04-01/07-2259 dhe në atë vendim
19 Gjykata e Apelit e GJPN-së e vërtetoi dhe konfirmoi vendimin e
20 Trupit Gjyqësor për të hedhur poshtë kërkesën e Mbrojtjes për
21 shkelje të të drejtave themelore të njeriut. Kjo ishte në
22 rastin e Katangës, por kjo ishte shumë herët në procedurën
23 gjyqësore dhe jo kaq vonë. Nuk mund të bësh një parashtrim kaq
24 të paqartë dhe një mocion kaq të paqartë në çfarëdo faze që të
25 duash. Kërkohet zell i duhur në punë dhe këto faktet që

1 mendojnë ata ose që pretendojnë ata se pengojnë procedurën dhe
2 që bllokojnë Mbrojtjen nga kryerja e detyrës së tyre, janë
3 ditur me kohë. Duhej të ishin paraqitur me kohë.

4 Por duke thënë që është e papërshtatshme të vendoset që
5 Mbrojtja e ka vërtetuar shtytjen për kryerje të veprës penale,
6 ngatërron dy gjëra. Domethënë, shtytjen në kuptimin procedural
7 dhe në atë kuptimin substantiv.

8 Theksimi i Mbrojtjes për sa i përket shtytjes së kryerjes
9 së veprës penale në kuptimin procedural, tregon që nuk e kanë
10 ngritur shumë mirë këtë çështje. *Prima facie* ata kanë ngritur
11 disa fakte në lidhje me këtë shtytje të kryerjes së veprës
12 penale, të cilat ishin po aq qesharake atëherë sa janë edhe
13 tani dhe do të ngre disa nga këto pika tani.

14 Por, tani ky është një aspekt ku gjykimi filloi dhe e
15 ndryshoi mënyrën se si është argumentuar. Mbani mend në fillim
16 që ZPS-ja tha që Paketa 1 mund të mbahej për një muaj, por kjo
17 ishte në listën e parë, jo në listën e dytë.

18 Paragrafit 134/a thotë që:

19 "Paketat 1, 2 dhe 3 ishin nën zotërimin e ZPS-së gjithë
20 kohën".

21 Por kjo nuk është vërtetë. Zonja Pumper tha që jo të
22 gjitha paketat të 1-shit dhe 2-shit ishin në bazat e të
23 dhënave të ZPS-së.

24 Dhe kundërshtimi nga Mbrojtja e Haradinajt, që nuk ka
25 prova për këtë fakt -- kundërshtimi tjetër i Haradinajt, për

1 atë nuk ka prova. Pra nuk kanë qenë të gjithë këto dokumente
2 në zotërim të ZPS-së.

3 Dhe siç mund të shihet nga tregues të tjerë edhe po të
4 ishte e vërtetë kjo, nuk do t'i jepte të drejtën të akuzuarit
5 që të pengonte procedurat dhe të shkelte sekretin e
6 procedurave.

7 134(b):

8 "Koordinimi i hetimit kryhet nga Prokurori i Specializuar
9 dhe Zëvendësprokurori i Specializuar".

10 Kjo është normale dhe s'ka asgjë kriminale këtu.

11 134(c):

12 "Nuk janë bërë përpjekje për të ndaluar fizikisht ndarjen
13 e paketave të dokumenteve".

14 Ka plot prova që tregojnë se ZPS-ja ka vepruar menjëherë
15 për t'i marrë këto paketa materiale. Ose kanë shkuar po atë
16 ditë ose kanë shkuar të nesërmen për t'i marrë ato dhe ZPS-ja
17 ka kërkuar autorizim për marrjen e tyre ose ka lëshuar urdhër
18 me nismën e vet. Pra brenda tre ditësh të akuzuarit u
19 arrestuan dhe u ndoqën penalisht.

20 Ne ishim të shqetësuar për këtë. Nuk ka argument për të
21 kundërtën.

22 134(d):

23 "Paketat 1 dhe 2 janë lënë qëllimisht në duart e OVL UÇK-
24 së gjatë natës".

1 Ju lutem, të nderuar Gjykatës, shikoni provat në lidhje
2 me këtë. Do të shikoni një diapozitiv, një pamje. Shikoni
3 kohën kur është bërë njoftimi, urdhrat që po priste Prokuroria
4 nga Gjykatësit për të marrë këto. E para ka 08:16 me 7
5 shtator, e dyta është në mëngjesin e 17 shtatorit, të vitit
6 2020. ZPS-ja po vepronte me gjithë shpejtësinë e mundshme për
7 të marrë këto materiale dhe asgjë nuk ju la që të kalonte një
8 natë kohë, deri të nesërmen në mëngjes.

9 134(e):

10 "Ka prova që zyrtarët e UÇK-së ishin nën vëzhgim në kohën
11 midis sjelljes së dokumenteve".

12 Jo, s'ka pasur prova të tilla. Nuk ka asnjë provë të
13 besueshme që ndokush nga ZPS-ja po vëzhgonte, po mbikëqyrte
14 OVL UÇK-në në atë kohë. Edhe në qoftë se e pranojmë se është e
15 vërtetë, do të ishte një hap i logjikshëm hetimor që ata
16 njerëz që kishin marrë këto materiale, të vendoseshin nën
17 mbikëqyrje, ky nuk është fakt që vërtetën shtytje për kryerje
18 të veprës penale.

19 134(f):

20 "Dërgesat që i janë dërguar OVL UÇK-së ishin një dokument
21 i punëve të brendshme dhe janë dërguar 13 ditë më përpara".

22 Kjo është një konspiracion që nuk ka asnjë provë.

23 "Nuk ka ndonjë kontroll të targave të makinave", që është
24 në 134(d) [sipas përkthimit].

25 Mbrojtja e Gucatit nuk jep asnjë provë dhe transkripti me

1 zonjën Pumper ku thotë që nuk di gjë për këtë çështje. Në këtë
2 rast, më lejoni të them që Mbrojtja e Gucatit e ka paraqitur
3 dëshmi në këtë pikë që është 1D31 dhe 1D32.

4 Por, edhe si në rastet e ngjashme, kjo ka të bëjë me
5 hetimin e gjerësishëm të ZPS-së. Mundësitë hetuese që ka pasur
6 ZPS-ja, janë funksione të prioriteteve dhe burimeve financiare
7 që ka dhe çështje, të cilat dalin përtej parametrave të kësaj
8 çështjeje. Ngulmimi i vazhdueshëm që mundësitë hetuese nuk
9 janë eksploruar në fakt përbëjnë pothuajse një pranim të
10 heshtur që hetimi i bërë për këtë çështje është i shëndoshë
11 dhe nuk mund të sulmohet dhe të dëmtohet.

12 134(h):

13 "Dokumentacioni vazhdon të botohet nga shtypi". Kjo nuk
14 tregon asgjë lidhur me fajësinë apo jo të të akuzuarit.

15 134(i):

16 "Raporti nuk mund të përfshinte mundësinë që dikush nga
17 ZPS-ja t'i kishte dërguar materialet një pale të jashtme".

18 Do t'ju jepja këtë citim nga i njëjti raport, në 1D33, të
19 nderuar Gjykatës, që thotë që:

20 "Nuk ka provë që një anëtar i shtabit të ZPS-së e ka
21 nxjerrë në mënyre të qëllimshme këtë dokument".

22 Pra, nuk ka prova.

23 134(j) - edhe këtu bëhet fjalë për hetimin e zgjeruar.

24 134(k) ka të bëjë me zyrtarin i cili ishte i ZPS-së, i

1 cili kemi diskutuar më parë.

2 Që ZPS-ja ka marrë një operacion të shpejtë për të
3 penguar operacionet e tij dhe për të frikësuar dëshmitarët e
4 tij në çështjen në fjalë dhe në çështje e tjera të krimeve të
5 luftës, është i pa pranueshëm. Pamundësi, Gjykata e të
6 Drejtave të Njeriut e ka paraqitur -- është shkruar, e ka këtë
7 tekst të shkruar dhe ka të bëjë me paragrafin 134 të Mbrojtjes
8 së Gucatit.

9 ZPS-ja nuk ka provë që të ketë shtytje për veprë penale.
10 Nuk ka prova që të jetë privatizuar nxitja nga ana e policisë
11 që ZPS-ja të ketë bashkëpunuar me palë të treta për t'i bërë
12 këto dërgesa. Nuk ka prova.

13 Këta të akuzuar nuk janë penguar dhe do të bënin atë që
14 dëshironin të bënin, pavarësisht çdo gjëje. Këtë ua ka thënë
15 vetë Gucati gjatë dëshmisë së tij dhe mund ta shihni këtë në
16 dëshminë në videon e tij.

17 [luhet videoincizimi]

18 "Py. Ju detyruan që t'i ndani këto dokumente me median. A
19 është kjo e saktë?

20 Pë. Vetëm Zoti më detyron mua se unë jam kryetari i asaj
21 Organizate dhe asnjë njeri nuk më detyron që të mbaj
22 konferencë për media për një punë të caktuar. Me këtë vetëm
23 zoti mund të më urdhëroj ta bëj".

24 Z. HALLING: [Përkthim] "Vetëm Zoti më detyron ta bëj".

25 Mendimi që ZPS-ja po vepronte për të diskretituar apo për

1 t'i mbyllur gojën Organizatës së Veteranëve të Luftës është
2 qesharake. I akuzuari e dinte që kjo gjë nuk ka ndodhur. Ata e
3 dinin që nuk do të rrezikoheshin nga ata persona të cilët i
4 kanë dërguar këto pakot te zyrat e tyre. Unë e përdora fjalën
5 "qesharake" në mënyrë të qëllimshme. Kur një gazetar e pyeti
6 Haradinajn nëse mund të rrezikoheshin për shkak të kësaj.

7 [Luhet videoincizimi]

8 Z. HALLING: [Përkthim] Askush nuk pajtohet nëse është --
9 ata e dinë që nuk janë duke u shtyrë për të bërë vepër penale
10 dhe e dinë një gjë të tillë.

11 Gabime ligjore. E kemi diskutuar shkurtimisht këtë nga
12 Mbrojtja e Gucatit. I akuzuari nuk ka vepruar, apo nuk i ka
13 marrë veprimet pasi ka marrë këshilla ligjore, ndryshe nga ajo
14 që thuhet në paragrafin 117 të dosjes së Gucatit.

15 Në fakt provat tregojnë që Tom Gashi është i caktuar për
16 të ndihmuar OVL UÇK-në vetëm pas konferencës së dytë të
17 shtypit dhe këshillat që ka dhënë ai kanë bërë thjeshtë
18 ratifikimin e asaj sjelljeje e cila ka vazhduar deri në atë
19 pikë dhe janë dy autoritete të cituara në paragrafin 117 të
20 dosjes së Gucatit në këtë paragraf që ka të bëjë me gabimet
21 ligjore.

22 Një nga të dy është P2 që ka të bëjë me konferencën e
23 dytë të shtypit, se si e dëshmon këtë gabim juridik P2, nuk ka
24 asnjë kuptim nga ana e Mbrojtësit të Gucatit, pasi kjo ka
25 ndodhur përpara se të caktohej një avokat.

1 Dëshmitë e të akuzuarit të marrë në tërësi e bëjnë të
2 qartë se ata nuk e kishin problem nëse ajo që po bënë ishte
3 në kundërshtim me ligjin.

4 Interesi publik tani. Interesi publik ka ndryshuar gjatë
5 shpjegimeve të mëparshme të Mbrojtjes dhe tani është e
6 ndryshme në dy ekipet e Mbrojtjes. Interesi publik informon
7 zbatimin e nxjerrjeve të autorizuara, në Pikat 5 dhe 6 të
8 Gucatit nuk ka të bëjë me Pikat 1 deri në 4 dhe është si pjesë
9 e të gjithë Mbrojtjes afirmative për të gjitha pikat nga ana e
10 Haradinajt.

11 Neni 392 (1) dhe (2) i Kodit Penal të Kosovës flasin për
12 nxjerrje të informacionit pa autorizim paraprak. Në qoftë se
13 përqendrohemi në Nenin 392(1), edhe në qoftë se mendohet që
14 një dokument është në interes publik, ky duhet bërë në
15 përputhje me ligjin. Nuk është e autorizuar siç thuhet në
16 fillim të asaj dispozite. Është bërë pa autorizim, pavarësisht
17 pretendimeve të tyre.

18 Neni 200 i Kodit Penal të Kosovës diskutohet gjerësisht
19 në dosjet përfundimtare. Ja disa nga pikat. Neni 200 i Kodit
20 nuk zbatohet nga ky Trup Gjykues. Ai duhet të ishte i
21 inkorporuar në nenin 32(c) të Ligjit. Neni 200 nuk është si
22 pikë mbrojtje për nenin 392 të Kodit dhe nënparagrafi 2, i
23 cili ka të bëjë me interesin publik për sa i përket nxjerrjes
24 së paautorizuar dhe aty është e qartë që kjo gjuhë nuk
25 zbatohet për krimin me të cilin është bërë ngarkimi penal në

1 bazë të nenit 392 të Kodit.

2 Neni 200(4) nuk është zbatuar, pasi aty thuhet që
3 nxjerrja e materialeve konfidenciale është në interesin publik
4 në qoftë se ka të bëjë me plane përgatitje apo krime kundër
5 rendit kushtetues apo integritetit territorial të Republikës
6 së Kosovës, apo veprat e tjera penale të cilat do t'i
7 kushtojnë dëmtime trupore apo vdekje një personi tjetër.

8 Si e kanë nxjerrë këtë konkluzion nga provat e paraqitura
9 këtu, më çudit, nuk mund ta bëjnë këtë. Nuk mund ta bëjnë
10 gjithsesi.

11 Ligji i klasifikimi i Kosovës, Ligji 03178, që përmendi
12 zonja Bolici në mëngjes, ka të njëjtin problematikë. Ai nuk
13 zbatohet nga DHSK-ja për shkak të ligjit [sipas përkthimit]
14 32(c) të Ligjit. Dhe kjo bëhet e qartë përmes nenit 62 të
15 ligjit.

16 Të gjitha dëshmitë e paraqitura në këtë çështje të çojnë
17 në drejtim të hetimeve penale për krime serioze të marra nga
18 një gjykatë e krijuar nga Kosova, e cila duhet të përmbushë
19 disa angazhime ndërkombëtare. Në qoftë se ky nuk është
20 dokument i klasifikuar me vlerë nuk di se çfarë mund të jetë.
21 Nuk ka prova që të provojnë të kundërtën.

22 I akuzuari nuk mund të ndërmarrë veprime të paligjshme
23 për shkak se nuk janë dakord me mënyrën se si është
24 klasifikuar informacioni. Të akuzuarit nuk janë duke u gjykuar

1 për ushtrime të të drejtës së lirisë së fjalës, siç thuhet në
2 paragrafin 58 të dosjes së Haradinajt. Ata janë në këtë gjyq
3 për pengesën e procedurave gjyqësore, frikësimin e
4 dëshmitarëve dhe dhunimin e sekretit të procedurave. Ky nuk
5 është në sulmim i tyre për shkak se janë kritikë të DHSK-së.
6 DHSK-ja ka mjaft kritika dhe njerëz që nuk janë dakord me të,
7 por këtu bëhet fjalë për ata çka kanë bërë të akuzuarit dhe
8 çfarë kanë thënë, e ajo është arsyeja se përse ata kanë ardhur
9 këtu në këtë Gjykatë.

10 Në këtë pjesë të dosjeve të palës Mbrojtëse bëhet një
11 diskutim i gjerësishëm i Halil Berishës. Halil Berisha është
12 paraqitur këtu dhe situata e tij nuk është e krahasueshme me
13 të akuzuarit ndryshe nga ajo që thuhet në paragrafin 127 të
14 dosjes së Haradinajt.

15 Nga ajo që është parë deri më tej, te redaktimet, te
16 synimet dhe te informacioni raportues, po ta kishin bërë të
17 njëjtën gjë të akuzuarit, siç bëri Halil Berisha, ata nuk do
18 të ishin sot këtu. Interesi publik për sa i përket Halil
19 Berishës, nuk është i njëjti koncept i cili mund të shfajësojë
20 të akuzuarit dhe kjo diskutohet gjerësisht në dosjen e
21 Haradinajt, në paragrafin 132 [sipas përkthimit] dhe pastaj në
22 447 deri në 60 në mes të tjerave.

23 Nuk ka dyshim që ky është një informacion interesant në
24 Kosovë. Dhe krimet e pranuar në video janë interesante nga
25 pikëpamja e publikut por kjo nuk do të thotë që është mbrojtje

1 për të akuzuarit. Kjo nuk mund të krahasohet fare. Dhe në
2 qoftë se keni nevojë për një autoritet tjetër për ta
3 mbështetur këtë argument, kjo mund të shihet nga fjalët e
4 zotit Haradinajt, kur pyetet nga *Gazeta* interview, në *inFokus*
5 kur bëhej fjalë për [e pakuptueshme].

6 [Luhet videoincizimi]

7 "Është më i miri. Ky ka pranuar me i marr, kanë mundur
8 edhe të tjerët. Ky ka bërë detyrën e vet".

9 Z. HALLING: [Përkthim] Pra ai donte të mbështeste të
10 tjerët. Tani do të vuajë të njëjtën gjë.

11 Dhe ky lloj argumenti tregon standarde të dyfishta nga
12 pala e Mbrojtjes së Haradinajt, ka të njëjtat mangësi si dy
13 citimet.

14 Ne i kemi ngarkuar këtë të akuzuar. Ato janë përgjigjes
15 për krimet e akuzuara.

16 Në fund të fundit, të gjitha argumentet e interesit
17 publik janë thjesht mënyra për të tërhequr vëmendjen apo për
18 të ndryshuar fokusin në këto dosje paraprake. Mendimi nga ana
19 e të akuzuarve që ZPS-ja është përzgjedhëse në mënyrën se si e
20 ushtron drejtësinë, është në fakt është përzgjedhëse vetë dhe
21 në shembullin 2903 të zotit Haradinajt, shihet se sa të
22 pasinqertë janë kur i konfrontohen me deklaratat të shkuara të
23 UÇK-së ku thuhet që UÇK-ja nuk ka bërë apo nuk mund të bënte
24 asnjë lloj krimi.

25 Zoti Gucati e thotë këtë në faqen 2369 të dëshmisë së

1 tij, dhe shembuj të ngjashëm shihen në P39-ET, faqe 4, P25-ET,
2 faqe 10, P49 faqe 16, P49 [sipas përkthimit], faqe 1.

3 Është e qartë se të akuzuarit besojnë se hetimi i duhur i
4 luftës së Kosovës do të çonte në procedimin vetëm të
5 keqbërësve serbë por jo të UÇK-së. Kur të akuzuarit akuzojnë
6 ZPS-në se ajo po ushtron drejtësinë selektive apo
7 përzgjedhëse, ata në fakt nënkuptojnë që ky Trup Gjykses nuk
8 është duke mbështetur drejtësinë e tyre përzgjedhëse. Kjo nuk
9 është çështje e një komenti apo shqetësimi të ligjshëm dhe nuk
10 ka qenë asnjëherë një çështje e tillë.

11 Të nderuar Gjykatës, të akuzuarit i kanë bërë këto krime
12 në mënyrë të hapur, këto i kanë bërë në video. Ata donin të
13 pengonin procedurat, ata donin të dhunonin sekretin e
14 procedurave dhe donin të frikësonin dhe të hakmerreshin kundër
15 atyre që kanë bashkëpunuar me këtë gjykatë. Kjo ka ndodhur dhe
16 ZPS-ja e ka provuar këtë lidhur me çdo element të të gjitha
17 pikave të aktakuzës. Dosjet e palës Mbrojtëse nuk dëshmojnë
18 asgjë tjetër. Ato nuk e dëshmojnë dhe nuk mund ta dëshmojnë.

19 Në paragrafin 510 të dosjes së Mbrojtjes së Haradinajt
20 ata thonë këtë:

21 “Kur bëhet fjalë për të vlerësuar ekuilibrin që duhet
22 vendosur në mes administrimit të drejtësisë dhe nxjerrjes së
23 dokumentit, të informacionit që është në interes të publikut,
24 ka çështje të cilat janë shumë të afërta njëra me tjetrën. Por
25 kjo nuk është një çështje e tillë”.

1 Ne jemi dakord. Dhe ne kërkojmë që ato të gjenden fajtorë
2 për të gjitha krimet me të cilat janë ngarkuar.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES, Z. SMITH: [Përkthim]
4 Faleminderit, zoti Halling. Tani do të marrim pushimin e
5 drekës dhe të gjithë do të kthehemi në orën 14:00 ku do të
6 dëgjojmë pyetje nga ana e Trupit Gjykses.

7 Të gjithë në këmbë.

8 --- Pauza e drekës fillon në orën 12:38

9 --- Seanca rifillon në orën 14:00

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Siç e thashë
11 para se të bënim pushimin, do të fillojmë me pyetjet nga Trupi
12 Gjykses.

13 Besoj që juve doni ta merrni fjalën i pari Gjykses
14 Barthe?

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit shumë Gjykses
16 Smith.

17 Pyetja ime e parë zonja Prokurore ose zoti Prokuror, ka
18 të bëjë me krimin e pengimit mbështetur në Nenin 401 të Kodit
19 përkatës Penal të Kosovës. Në paragrafin 173 të dosjes
20 përfundimtare të çështjes, ju thoni që:

21 "Zbulimi i paketave e ka detyruar ZPS-në që të ndryshonte
22 nivelin e burimeve për të kontaktuar me to" dhe vazhdohet më
23 tej që "Z. Jukiç tha që pas konferencës së tretë për shtyp ka
24 vijuar me marrjen në telefon të dëshmitarëve dhe ndërkohë që
25 janë marrë masat e nevojshme për të bërë kontaktimin e sigurt

1 me dëshmitarët dhe është dashur gjithashtu që të bëheshin
2 planet e menaxhimit të riskut në rast emergjence për
3 dëshmitarët. Ndërkohë që vijohet më tej që 20 deri 30
4 dëshmitarë kanë marrë masat mbrojtjeje. Ndërkohë që 2
5 dëshmitarë të tjerë janë zhvendosur nga Kosova në kuadrin e
6 nivelit të lartë të kërcënimeve”.

7 Zoti Prokuror, mund të argumentohet që kjo do të thotë që
8 ZPS-ja duhet të bënte përpjekje për të garantuar sigurinë e
9 dëshmitarëve, por si tregon kjo që puna e ZPS-së apo puna e
10 ndonjërit prej punonjësve të ZPS është penguar aktualisht?

11 Me fjalë të tjera, a po parashtrojmë ju që, vetëm fakti që
12 anëtarët e ZPS-së, si z. Jukiç, puna e të cilit është vetëm
13 thjeshtë për të mbrojtur dëshmitarët, duhej që të punonte më
14 tepër dhe kjo në vetvete dëshmon që ZPS-ja përmbush mandatin e
15 vet për të hetuar dhe për të përndjekur penalisht krimet?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

17 ZPS-ja pretendon se puna e saj është penguar në shumë
18 aspekte pas kërcënimeve serioze të të akuzuarit. Kalimi ose
19 tjetërsimi i burimeve të brendshme të ZPS-së është njëra prej
20 elementëve që përmenden në paragrafin e lexuar prej jush, i
21 nderuar Gjykatës. Por kemi gjithashtu edhe aspekte të tjera të
22 pengesës së punës të ZPS-së.

23 Mandati i ZPS-së është që të jetë në gjendje që të
24 realizojë hetimet penale dhe të jetë në gjendje që të sigurojë
25 bashkëpunimin e dëshmitarëve dhe të akuzuarit kanë cenuar,

1 kanë kompromentuar thelbësisht një gjë të tillë.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit zoti Prokuror.

3 Pyetja e radhës është kjo, ka të bëj sërish me krimin e
4 pengimit që parashikohet në Nenin 401 të Kodit Penal të
5 Kosovës. Të supozojmë që ky Trup Gjykues është vetëm i bindur
6 që ka pasur një tentativë sa i takon pengimit aktual, por
7 ndërkohë çfarë mund të thoni sa i takon parashikimit të nenit
8 401 dhe që parashikohet që, duhet që pengimi i ushtrimit të
9 detyrave zyrtare duhet që të jetë një proces dhe një shkelje e
10 plotë?

11 Sipas mendimit tuaj, a është e nevojshme që të aplikohet
12 dispozita e përgjithshme për përpjekjen në nenin 28 të Kodit
13 Penal të Kosovës në një konstelacion ose në një tjetër?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Në dy alternativat që dhatë juve,
15 mendojmë që duhet të ishte kjo e fundit. Pra duhet të ishte
16 pengesa e plotë e të akuzuarve. Dhe për pasojë është e
17 nevojshme që të bëhet përpjekja e plotë apo të vërtetohet
18 përpjekja e plotë e pengimit.

19 Ndërkohë sa i takon parashikimeve të Kodit, në mënyrë që
20 të kemi të bëjmë me një situatë të konstelacionit të fundit,
21 mendojmë që ka kuptim që, fjala "attempt" që është në
22 anglisht, apo fjala "përpjekje" duhet që të materializohet dhe
23 të duket se është realizuar.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe në nenin 28 Kodit, kjo
25 nuk është e zbatueshme. E kuptoj siç duhet, apo jo?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Orvatja është një ndër mënyrat,
2 alternativat e përgjegjësive penale që kemi përdorur neve.
3 Mbase duke përdorur gjuhën e nenin 28, do të duhet që të bëjmë
4 interpretimin e nenit 401. Dhe i takon që duhet që të
5 frymëzohemi nga mënyra se si përkufizohet kjo fjalë në
6 dispozita të tjera ligjore.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Vazhdojmë tek dënimi. Sa i
8 takon dënimit, do të merremi të enjten, kështu që nuk ia vlen
9 që të bëj pyetje lidhur me këtë element.

10 Pyetja tjetër ka të bëjë me krimin ose me akuzën e
11 kërcënimit që parashikohet në nenin 387 të Kodit Penal të
12 Kosovës. Në paragrafin 219 të dosjes tuaj ju thoni dhe e citoj
13 këtu:

14 "Provat vërtetojnë që të akuzuarit ishin në dijeni që --
15 ose po i nxisnin dëshmitarët që të mos jepnin informacion dhe
16 deklaratatë të sakta ose që të tërhiqeshin nga dhënia e
17 deklaratave për Dhomat e Specializuara të Kosovës. Të
18 akuzuarit kanë shprehur në mënyrë të vetëdijshme motivimet për
19 të penguar punën e DHSK. Po ashtu, të akuzuarit janë të
20 ndërgjegjshëm për rezultatin që veprimet e tyre kanë ndaluar
21 dëshmitarët dhe gjithashtu kanë dhënë pasoja të cilat janë të
22 ditura".

23 Ndërkohë në paragrafin 214 ju thoni që, "të akuzuarit
24 ishin plotësisht të vetëdijshëm që sjellja e tyre do të çonte
25 në frikësimin e të akuzuarve". Dhe gjithashtu ju thoni që "të

1 akuzuarit kanë vepruar me qëllim negativ ndaj DhSK".

2 Dhe së fundmi në paragrafin 218, ju thoni që:

3 "Të akuzuarit kanë pasur mundësi që përmes deklaratave të
4 tyre, të kishin ndikimin e bërjes së deklaratave të rreme nga
5 dëshmitarët ose të tërhiqeshin fare nga dhënia e deklaratave,
6 sipas parashikimeve të nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës".

7 Zoti Prokuror, a është e saktë, në qoftë se e mbani mend
8 juve, që të akuzuarit kërcënonin dëshmitarët. Pyetja ime ka të
9 bëj me "*mens rea*", me këtë parim që parashikohet në nenin 387.
10 A thoni që është përtej dyshimit të arsyeshëm që vërtetohet
11 që, qëllimi apo synimi i të akuzuarve ishte që të kërcënonin
12 dëshmitarët. Dhe në qoftë se e mendoni këtë gjë, ju lutem na e
13 shpjegoni pak se, pse e keni këtë pozicion? Apo po thoni që
14 Trupi Gjykses mund të zbatojë një tjetër formë synimi që mund
15 të jetë për shembull, thjesht njohuritë mbështetur nga provat
16 që kemi përpara nesh?

17 Nga perspektiva juaj, forma e synimit a bën dallim sa i
18 takon qëllimeve të dënimit për të akuzuarit?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
20 Përgjigja për pjesën e parë të pyetjes tuaj ka të bëjë me
21 seksionet në teori dhe gjithashtu edhe me pjesën praktike që
22 ne kemi dhënë në dosjen tonë. Në seksionin e analizës, neve
23 përfshimë paragrafin 214, dhe kjo nuk ka të bëjë detyrimisht me
24 gjurmimin e gjuhës statutore. Është thjesht një argument që ka
25 të bëjë me provat.

1 Por ajo çfarë duhet të zbatohet këtu, është interpretimi
2 ose formulimi i DhSK. Dhe këtu veçanërisht neve i referohemi
3 paragrafit 219 konkretisht. Dhe kjo ka të bëj me parimin e
4 "mens rea".

5 Neni përkatës i Kodit, ka të bëj me synimin e
6 drejtpërdrejt. Kurdo që ne ngremë akuza kundër të akuzuarve,
7 neve i akuzojmë ata në mënyrë alternative. Pra ne besojmë që
8 ka prova për synim të drejtpërdrejtë dhe për synim eventual.

9 Ju pyesni se ku është prova në synimin e drejtpërdrejtë.
10 Ndërkohë referencat dhe pjesa teorike janë të lidhura me
11 deklarimin e fakteve. Për shembull, ne kemi të akuzuarit të
12 cilët vetë e njohin, e pranojnë motivimin që kanë mbas
13 veprimeve të tyre. Për shembull në poshtëshënimin 638, në
14 kros-referimin që ne kemi vendosur aty, neve mendojmë që e
15 kemi vërtetuar këtë synim të tyre.

16 Sa i takon nivelit të synimit, që është i rëndësishëm për
17 arsye të dënimit, ka shumë gjëra të cilat duhen të merren
18 parasysh lidhur me dënimin. Ndërkohë që niveli i synimit është
19 vetëm njëri prej këtyre elementëve. Ne argumentojmë që, synimi
20 i të akuzuarve është kaq i rënduar sa duhet që të ketë një
21 peshë shumë të madhe në dënimin e këtyre të akuzuarve.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Me fjalë të tjera zoti
23 Prokuror, ju kërkoni synim alternativ eventual vetëm në të
24 kundërtën, domethënë në qoftë se ne nuk marrim parasysh
25 elementin e parë të ngritur nga juve, pra sa i takon synimit

1 të frikësimit të dëshmitarëve?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Siç e kemi
3 shpjeguar, ne mendojmë që synimi i drejtpërdrejtë i të
4 akuzuarve është i vërtetuar në çështjen në fjalë.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani kam
6 pyetje të cilat kanë të bëjnë me mënyrat e përgjegjësisë
7 penale, në veçanti nxitja ose shtyrja në kryerjen e krimit.

8 Në paragrafin 41 të aktakuzës, zoti Gucati, zoti
9 Haradinaj nxitën njëri-tjetrin, bashkëpunëtorët e të tjerët,
10 persona të cilët i kanë ndjekur ato në distancë në mënyrë që
11 të bëjnë veprime të tilla. Përfshirë këtu edhe personat e
12 shtypit, por gjithashtu edhe persona të cilët kanë qasje në
13 informacionin konfidencial dhe jo publik. Për më shumë detaje,
14 ju lutem referojuni paragrafit 41 të aktakuzës.

15 Ndërkohë, në dosjen tuaj përfundimtare në paragrafin 263,
16 ju thoni që:

17 "Të akuzuarit kanë nxitur median për të kryer veprën
18 penale".

19 Paragrafi 268 thotë që:

20 "Në fakt është media Kosovare që ka dëmtuar dhe më tej
21 pozicionin e të akuzuarve, sepse ata i kanë inkurajuar mediat
22 që të botonin plotësisht informacionet e dhëna në paketa, duke
23 i inkurajuar ato duke thënë që, mediat të cilat i kanë botuar
24 këto informacione janë të guximshëm".

25 Dhe thuhet po ashtu në paragrafin 270 që:

1 "Ndikimi ka qenë që të akuzuarit kanë ushtruar ndikim
2 psikologjik, sa i takon veprave në fjalë".

3 Zoti Prokuror, lidhur me këto pika, kam disa pyetje.

4 Pyetja e parë është kjo, a jeni dakord që nxitja e
5 ndërsjellë e të akuzuarve, ashtu siç thoni në paragrafin 270 e
6 thënë me fjalët tuaja, ushtrimi i ndikimit psikologjik për të
7 nxitur njëri-tjetrin, ushtrohet nga bashkëkryerja e veprës
8 penale që kërkon një pajtim të ndërsjellë, në mënyrë të tillë
9 që bashkëkryesit në një rast të tillë të jenë po ashtu në
10 mënyrë të barasvlershëm përgjegjës për një nxitje të tillë të
11 ndërsjellë?

12 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mund ta çoj më
13 tej këtë pyetje.

14 Po, në përgjigje të pyetjes suaj mund të them, po. Mund
15 të jetë kjo rasti. Në qoftë se juve konstatoni që të akuzuarit
16 kanë nivele të ndryshme përgjegjësie, por arsyeja sepse
17 bashkëkryerja në vetvete është parimi kryesor i përgjegjësisë
18 penale së bashku me kryerjen në mënyrë të drejtpërdrejtë,
19 atëherë rasti është ky. Pra ajo çfarë shpjeguat juve.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po. Pyetja tjetër që kam
21 lidhur me këtë temë zoti Prokuror, është të na thoni se si
22 Trupi Gjykues mund të arrijë në përfundimin që, individit ose
23 individët kanë qenë përgjegjës për ofrimin e informacionit për
24 OVL e UÇK në tre raste të ndryshme në shtator të vitit 2020?
25 Dhe se si këta persona kanë nxitur ose kanë ndikuar

1 psikologjikisht në mënyrën se si të kryhen krime kundër të
2 akuzuarve, domethënë si mund të vërtetohet që veprimet e të
3 akuzuarve kanë pasur efekt mbi personat të cilët kanë rrjedhur
4 ose kanë dërguar dokumentet tek OVL e UÇK, ndërkohë që ne nuk
5 i dimë ende se kush janë këta persona?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar, neve mund të themi që
7 akuza është si një rrjedhë sjelljeje. Është dhënë në dosjen
8 time që të akuzuarit i kanë mirëpritur prurjet e informacionit
9 në mënyrë publike. Besoj që i mbani mend edhe citimet që kanë
10 dhënë të akuzuarit, të cilët janë pjesë e procesverbalit dhe
11 ata kanë thënë që, pavarësisht se kush janë këta persona. Dhe
12 thirrjet e tyre janë nxitje të këtyre krimeve dhe krimeve të
13 tjera.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në qoftë se e mbaj mend siç
15 duhet zoti Halling, keni qenë ju që keni thënë, kam
16 përshtypjen që e keni thënë në procesin gjyqësor më datë 26
17 tetor 2021, të paktën edhe sot e keni shprehur në prezantimin
18 tuaj në mënyrë të tërthortë që, zoti Berisha nuk ka kryer krim
19 kur ka botuar ose kur punëdhënësi i tij, gazeta inFokus,
20 vendosi që të botonte informacionin ose pjesë të informacionit
21 që ishte pjesë e paketave. A është e saktë kjo?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po, kështu është. E saktë është.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po pse mendoni që zoti
24 Berisha nuk ka kryer një krim? Ose për të qenë më preciz, më i
25 saktë, cilët janë elementët, për shembull, në nenin 392(1)

1 cilët nga këto elementë të cilët nuk janë përmbushur nga z.
2 Berisha dhe që do ta përjashtonin z. Berisha nga fajësia dhe
3 që ju arrini në përfundimin që, nuk kërkohet një dënim për z.
4 Berisha mbështetur në nenin 32(1) të Kodit Penal të Kosovës?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Për t'u përqendruar në pjesën e
6 parë të pyetjes suaj, sjellja e zoti Berisha është e dukshme
7 dhe e qartë dhe bie nën fushën e veprimit të "*actus reus*" dhe
8 "*mens rea*". Dhe situata e të akuzuarve është e ndryshme nga e
9 zotit Berisha. Ne jemi të ndërgjegjshëm për faktin që ka
10 mënyra të tjera për kategorizimin e kësaj sjellje dhe kjo
11 është arsyeja që pse nxitja në krim është mënyra alternative e
12 përgjegjësisë penale. Dhe e di që kjo në fakt nuk ka të bëjë
13 thjeshtë me pikën 5, por kjo është mënyra se si ne e
14 parashtrojmë këtë.

15 Pra, nga njëra anë neve e pranojmë që, ju të nderuar
16 Gjykatës keni një kuptim tjetër nga kuptimi jonë, por ne
17 kështu e kuptojmë situatën që zoti Berisha nuk është
18 përgjegjës dhe sjellja e të akuzuarit është e ndryshme nga
19 niveli "*mens rea*" dhe "*actus reus*".

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe së fundi zoti Halling,
21 pyetja ime e fundit është kjo, është pyetje e cila ka të bëjë
22 me nxitjen, me shtytjen në krim. Unë dua të di se, cilët janë
23 gazetarët që janë nxitur nga të akuzuarit dhe që nuk kanë
24 kryer ose nuk janë orvatur për të kryer një prej krimeve të
25 cilat janë parashikuar në nenin 32(2) të Kodit Penal të

1 Kosovës?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Gazetarët për të cilët ju po
3 flisni janë të gjithë ata gazetarë të cilët i kanë pasur
4 paketat e informacionit në këto konferenca për shtyp. Sa i
5 takon mënyrës se si këto krime mund të ishin përpjekur që të
6 bëheshin nga këta persona plus, është një funksion i asaj
7 çfarë juve e quani "ligj i zbatueshëm".

8 Për shembull, në qoftë se ju të nderuar Gjykatës do të
9 arrini në përfundimin që krime të caktuara kanë elementë të
10 pasojës dhe jo elementë të sjelljes, mund të jetë e mundur që
11 gazetarët të kenë parimin e "mens rea" por jo të "actus rea".
12 Nga ana tjetër kjo ka të bëjë gjithashtu edhe me teorinë e
13 përgjithshme të çështjes.

14 Dhe teoria kryesore jona është që, të akuzuarit janë
15 përgjegjës për këto krime. Dhe në qoftë se ju jeni dakord me
16 neve, ju do të arrini vetë në përfundimet ose nuk do të
17 bëheshin pyetje të tilla për nxitjen ose shtytjen në kryerjen
18 e krimit.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
21 Mettraux.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Zoti Halling, do të dua që
23 t'ju kthej sërish tek pika 1, pengimi. Dua konkretisht që t'ju
24 sjell në vëmendje paragrafët 173, 174, 190 të dosjes tuaj.

25 E kuptoj që ju bëni 2 sugjerime të ndryshme këtu. Njëri

1 prej sugjerimeve është që, sjellja e të akuzuarve e ka
2 detyruar ZPS-në që të përdorte më shumë burime, që të
3 ndryshonte rrjedhën e burimeve në mënyrë të tillë që të mund
4 të kontaktonin më dëshmitarët e tjerë. Dhe elementi i dytë
5 është që, të akuzuarit përmes veprimeve të tyre kanë cenuar në
6 mënyrë thelbësore aftësinë e ZPS-së për të hetuar dhe për të
7 ndjekur penalisht në mënyrë efektive.

8 Tani e kuptoj përgjigjen që i dhatë Gjykatësit Barthe sa
9 i takon komprometimit të hetimeve dhe ndjekjeve penale dhe sa
10 i takon aftësisë për të siguruar bashkëpunimin e dëshmitarëve.
11 Është ky pozicioni juaj, në qoftë se mund t'ju kërkoj për të
12 qenë më i qartë?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Paragrafi
14 191 i dosjes tonë lidhet me pyetjen tuaj.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sipas jush, cilat janë
16 provat mbi të cilat ne duhet të mbështetemi lidhur me
17 propozimin e dytë, që të jemi në gjendje që të sigurohej
18 bashkëpunimi i dëshmitarëve, në rastin tuaj?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Ne kemi provat nga zoti Jukiç edhe
20 zonja Pumper lidhur me dëshmitarët të cilët thanë që,
21 dëshmitarët nuk dëshironin që të bashkëpunonin më me ZPS pas
22 nxjerrjes së informacionit nga paketat. Kemi gjithashtu edhe
23 provën e klimës së kërcënimit, përfshirë këtu edhe dëshminë e
24 zoti Reid, i cili flet për klimën e kërcënimit dhe që ka folur
25 gjithashtu edhe për mënyrën se si konsideroheshin dëshmitarët.

1 Dhe dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mandatin e
2 ZPS-së janë të rëndësishme në këtë kontekst, sepse çështje të
3 ZPS-së duhet që të mbështeten në dëshmitë e dëshmitarëve. Dhe
4 në qoftë se do të përdor të njëjtën gjuhë që ne kemi përdorur
5 në paragrafin 191, do të thoshim që dëshmitarët kanë ndier
6 frikë, shqetësim dhe sigurisht një ndjesi e tillë kërcënimi
7 dhe intimidimi, do të kish patjetër pasoja tek dëshmitarët.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] T'i kthehem tani pikës 3
9 dhe 4 të Aktakuzës. A mund të na shpjegoni se cila është
10 marrëdhënia midis këtyre dy pikave të aktakuzës? Faktikisht
11 apo thoni që ato lidhen të paktën pjesërisht me disa njerëz të
12 caktuar, me disa rrethana aktuale të caktuara, apo me
13 elementët ligjor të tyre? Pra, çfarë sjelljeje mendoni ju,
14 kapet nga pika 4 që nuk përfshihet në pikën 3 të aktakuzës?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Këto sjellje përfshijnë elemente
16 të përbashkët. Por dallimi është tek elementët ligjor.

17 Ato reflektojnë interesa të ndryshme të mbrojtura. Këtë
18 mund ta shikoni në mënyrën se si i paraqet Kodi Penal i
19 Kosovës. Mënyra se si formulohet frikësimi, tregon se ajo ka
20 orientim nga e ardhmja, që të mos i lejosh njerëzit që të
21 flasin. Ndërsa hakmarrja ka të bëjë me atë që është bërë më
22 përpara.

23 Por sjellja e të akuzuarve mbulon edhe aspektin e të
24 ardhmes edhe atë të së kaluarës. Prandaj dhe ju duhet t'i
25 shikoni të dyja dhe të jepni vendime fajësie për të dyja, në

1 mënyrë që të reflektohet fajësia e të akuzuarve.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për pikën 4. Diçka që
3 thoni ju në paragrafin 221 të dosjes tuaj, do ta lexoj pjesën.
4 Aty thuhet:

5 "Dëshmitarët kundër të cilëve u mor hak, brenda kuptimit
6 të kësaj pike, ndër ta përfshihen autoritetet qeveritare që
7 dhanë dokumente ku përcaktoheshin krimet dhe kryesit e krimeve
8 relevante, apo që lehtësuan ata që kishin këtë informacion të
9 tillë".

10 Së pari dua të di këtë parashtrim, ky ka të bëj me dy
11 kategori të zyrtarëve qeveritar? Janë këto persona që ju keni
12 kërkuar të bëni intervista për të marrë ndihmën e tyre në
13 lidhje me hetimin tuaj? Pra, a po i kërkon Panelit që të
14 shohë të dy këto kategori, kur të marrë vendim në lidhje me
15 Pikën 4, fushë veprimin e tij?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Pika e fundit e paragrafit e
17 reflekton këtë. Në qoftë se do të jetë vendimi i juaj që nuk
18 ka arsye pse të ngrihet çështja kundër tyre, atëherë për këtë
19 e kemi trajtuar këtë çështje.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe në qoftë se do t'ju
21 kërkojmë të identifikoni se ku në Aktakuzë e keni futur këtë
22 sugjerim?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Është kombinim i paragrafit 4 të
24 Aktakuzës së bashku me paragrafin 31, ku trajtohet hakmarrja.
25 Paragrafët 31 dhe 32. Gjithashtu termi "dëshmitar", mënyra e

1 përdorimit të këtij termi përfshin edhe zyrtarët shtetërorë.

2 Domethënë është përkufizuar në mënyrë të tillë që të futen aty
3 edhe këta dëshmitarë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në paragrafin 239 të
5 dosjes tuaj, do ta lexoj:

6 "Të akuzuarit nuk është e nevojshme të kenë dijeni për
7 ligjin përkatës apo për urdhrin e gjykatës që i jep mbrojtje
8 dëshmitarëve në fjalë. Dhe të akuzuarit duhet të dinë që
9 informacioni i dëshmitarëve është i mbrojtur ose mund të jetë
10 i mbrojtur".

11 Çfarë sugjeroni ju, cili është standardi që duhet zbatuar
12 për sa i përket asaj që nuk përmbushen kushtet e parimit të
13 legjitimitetit dhe të ligjshmërisë? A po thoni që kjo nuk
14 është kërkesë, të paktën teori mbi bazën e të cilit kur diçka
15 ose dikush që është objekt i konfidencialitetit apo sekretit,
16 duhet të ketë qenë i qasshëm ndaj të akuzuarve? Çfarë po
17 thoni?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Për sa i përket parimit të
19 ligjshmërisë, ka të bëjë me nenin 21 të Kodit Penal
20 drejtpërsëdrejti. Ne po argumentojmë në dosjen tonë që është
21 zbatimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i kontestit të
22 njohurive të tyre, në lidhje me statusin e mbrojtur të
23 informacionit. Pra, ne po thoshim që të akuzuarit janë shtetas
24 të Kosovës dhe e dinë që kur kanë vepruar ashtu, kanë vepruar
25 kundër ligjit.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndoshta nuk e thashë shumë
2 konkretisht, por për shembull, për faktin që disa dëshmitarë
3 kishin marrë masa mbrojtëse të cilat ishin urdhëruar për ta.

4 Çfarë do të thoni për sugjerimin se, një vendim fajësie
5 për nxjerrjen e informacionit mbi bazën e një urdhri të tillë,
6 do të përbënte një shkelje të parimit të ligjshmërisë në atë
7 masë saqë -- sepse faktikisht nuk është demonstruar që ata
8 mund ta kenë ditur që ka ekzistuar një urdhër i tillë.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sipas provave
10 tona që janë përfshirë në atë grup faktesh, ne kemi status të
11 mbrojtur të informacionit dhe sipas autoritetit të ZPS-së,
12 sipas ligjit për klasifikimin e këtij informacioni kemi masa
13 mbrojtëse dhe vendimi për masa mbrojtëse që janë marrë nga kjo
14 gjykatë dhe kemi masa mbrojtëse që janë marrë në Kosovë së
15 bashku me një letër nga një organizatë ndërkombëtare.

16 Pra, duke u fokusuar tek ligjshmëria për një grup
17 provash, duke përjashtuar të tjerat, është pikërisht mënyra se
18 si e kemi ngritur këtë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për sa i përket paragrafit
20 272 të dosjes tuaj:

21 "Prokuroria nuk ka akuzuar ndonjë bashkëpunëtor apo
22 persona të tjerë që kanë krime në lidhje me paketat e
23 materialeve".

24 Pastaj thoni që:

25 "Nëse Paneli mendon që këto krime janë kryer nga këto

1 persona, atëherë të akuzuarit mund të gjenden fajtorë edhe se
2 kanë ndihmuar këto krime”.

3 Tani, a po i kërkon Panelit që të vendosin për vendim
4 fajësie për të akuzuarit për këto palë të treta që i kanë
5 ndihmuar, këto palë të treta për të cilat nuk është ngritur
6 aktakuzë? Dhe si e lidhni ju këtë me prezumimin e pafajësisë?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është e përfshirë në format e
8 përgjegjësisë për të cilat kemi ngritur akuzë, që ka edhe
9 persona të tjerë përtej aktakuzës që mund të kenë kryer krime.
10 Këta njerëz janë identifikuar në bazë të klasifikimit të tyre,
11 shkallës, nivelit të tyre, ka emra konkretë që janë dhënë dhe
12 është bërë një mocion paraprak për këto emra. Pra, ne themi që
13 nuk është problem që të zbatohet kjo forma e përgjegjësisë e
14 asistencës, e ndihmës, në qoftë se ju do të arrini tek
15 alternativa.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, nuk do të thoshte
17 kjo që në praktikë Panelit do t’i kërkohej që të bëjë
18 konstatime për fajësinë në lidhje me -- të personave të tjerë.
19 Ata do të jenë të akuzuar dhe do të gjenden fajtorë për këto
20 krime të asistencës, në qoftë se parimet e tjera janë
21 plotësuar. Kjo do ta vinte Panelin në një pozitë që duhet të
22 vendosë që ata janë fajtorë në lidhje me asistencën, apo jo?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo lidhet me atë çështjen e
24 personave të tjerë për të cilët nuk është ngritur aktakuzë
25 edhe ka pasur çështje në Gjykatën Evropiane të Drejtave të

1 Njeriut. A ka pasur një kryes tjetër të cilin akuzohet se e ka
2 ndihmuar apo e ka asistuar i akuzuari aktual, atëherë do të
3 bëhet gjyq i ri me prova të reja. Ky është një konstatim që ju
4 duhet ta bëni në kontekstin e përgjegjësisë të zotit Gucati
5 dhe zotit Haradinaj. Vendimi juaj do të jetë i lidhur me to.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Paragrafi 278 thotë që:

7 "Të akuzuarit kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme
8 dhe kanë ndërmarrë akte të konsiderueshme për kryerjen e
9 krimeve për të realizuar qëllimin e përbashkët dhe
10 marrëveshjen e përbashkët".

11 A mund të na thoni se vetëm parja e informacionit
12 konfidencial, si përbën ajo kontribut të konsiderueshëm ndaj
13 qëllimit të përbashkët?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Pjesa e kontributit të
15 konsiderueshëm dhe bashkëkryerja, janë të gjitha të lidhura së
16 bashku dhe ne nuk i shikojmë që t'i shikoni në mënyrë të
17 izoluar.

18 Argumenti ynë është që të gjitha elementët, të gjitha
19 provat të vendosura së bashku, mbi bazën e tyre mund të
20 vendoset se është përmbushur pragu i kontributit të tyre.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, për Mbrojtjen. Do
22 të filloj me çështjen e shtytjes për kryerjen e veprës penale.
23 Kur i përgjigjeni mbrojtjes, të dy ekipeve të Mbrojtjes në
24 lidhje me abuzimin e procesit.

25 Faktikisht, ky termi abuzim i procesit është përdorur nga

1 zoti Cadman përfaqësuesi i zotit Haradinaj, kurse zoti Gucati
2 përmend një ndalim të procesit gjyqësor, që është një nga
3 masat ligjore që jepet në disa sisteme gjyqësore në lidhje me
4 teorinë e abuzimit të procesit.

5 Pra, dua të pyes nëse ju e pranoni se kjo masë ligjore,
6 qoftë nëse e quani ju abuzim i procesit apo ndalim i procesit
7 gjyqësor, a është pjesë e rendit tonë ligjor këtu? Dhe dua të
8 përmend këtu që zoti Rees i referohet rregullës 110 të
9 Rregullores që ka të bëjë me aftësinë e Panelit për të
10 urdhëruar ndalimin e procesit gjyqësor, përfundimin e procesit
11 gjyqësor nëse janë bërë shkelje të procesit të nxjerrjes.

12 Pra, ju e pranoni që Paneli ka autoritetin që të japë një
13 masë të tillë ligjore?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Ne e pranojmë që Paneli ka
15 juridiksionin dhe autoritetin për ta dhënë këtë. Por ne e
16 kuptojmë se mënyra se si po argumenton Gucati dhe Haradinaj
17 dhe e kuptojmë kështu që, ndalimi i procesit gjyqësor është
18 masa ligjore që kërkohet dhe abuzimi i procesit është
19 justifikimi për ndalimin e procesit gjyqësor.

20 Ne e pranojmë që në qoftë se zbatohen kështu parimet e të
21 drejtave të njeriut, mund të kërkohet një masë ligjore e
22 tillë, por nuk ka lidhje kjo masë ligjore dhe këto rrethana me
23 çështjen tonë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndoqa traditën e
25 Kryegjykatësit në lidhje me mikrofonin që nuk e ndeza.

1 Paragrafët 284, 285 dhe 287. Unë do të bëj një pyetje të
2 përgjithshme. Ju nuk jeni dakord me Mbrojtjen për sa i përket
3 shtytjes për kryeje të veprës penale, interesit publik,
4 gabimet ligjore, gabimet të faktit.

5 Dua t'ju pyes këtu, interpretimin e sistemit tonë
6 normativ, ne duam të sigurojmë që interpretimi të jetë në
7 përputhje me standardet e të drejtave të njeriut? E pranoni
8 këtë?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Dua të them "po". Por dua të
10 sqaroj se çfarë dua të them kur them "po". Ne jemi dakord se
11 në teori në qoftë se do të ekzistonte shtytja për kryeje të
12 veprës penale, atëherë teorikisht këto mund të ishin masa që
13 mund të merren sipas Gjykatës Evropiane të Drejtave të
14 Njeriut. Por nuk do të thotë që ka një mbrojtje afirmative
15 ndaj këtyre krimeve.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju thoni se rregulla 95(5)
17 nuk është shteruese.

18 Në qoftë se ne do të përpiqeshim të përcaktonim se ku
19 ndalon ky efekt joshterues i këtij ligji? Çfarë do të thoni
20 për ankesën që ne po e trajtojmë të pandehurin ndryshe dhe në
21 lidhje me paragjykimin që do të kishin këta të pandehur në
22 trajtimin e tyre në këtë gjykatë krahasuar me gjykatat e
23 tjera? Dhe ku Mbrojtja, për sa i përket gabimeve ligjore dhe
24 gabimeve faktike, do të ishte diçka që do ta kishin në
25 dispozicion.

1 Ju, mendoni se këto janë relevante si konsiderata?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Unë them që kjo ka të bëjë vetëm me
3 gabimet ligjore, sepse shtytja për kryerje të veprës penale
4 dhe interesi publik, nuk kanë dispozita ligjore në Kodin Penal
5 të Kosovës. Do të ishte vetëm gabim ligjor sipas nenit 26 të
6 Kodit Penal të Kosovës.

7 Ne kemi bërë argumentin në një paragraf të dosjes sonë që
8 në qoftë se kjo konsiderohet si pjesë e ligjit material,
9 ligjit substantiv, duhet të shprehet në mënyrë të qartë. Ne e
10 pranojmë që rregulla 95(5) ekziston dhe mund të arrihet një
11 konkluzion i ndryshëm.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime e fundit. A
13 mund të na -- duke pasur parasysh se ju në dosjen tuaj e thoni
14 çfarë është gabim ligjor, çfarë është gabim faktik dhe për ta
15 bërë të thjeshtë ju thoni se do të ishte mbrojtje e vlefshme në
16 qoftë se ata e mohojnë "mens rea" të të akuzuarit. Dhe ju
17 përmendni precedentë nga Tribunali i Hagës, Tribunali i
18 Ruandës dhe Gjykata Penale Ndërkombëtare.

19 A mund të na e shpjegoni se çfarë janë gabimet ligjore
20 dhe gabime fakti që mund t'i gjejmë në Kodin Penal të Kosovës?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Ne i përmendëm ato sepse mendojmë
22 që ato precedentë mund t'ju udhëzojnë në vendimin tuaj. Ne
23 flasim për dispozitën ligjore në kodin penal në lidhje me
24 gabimin ligjor dhe po të shikoni poshtëshënimin 790, ne themi
25 që megjithëse nuk zbatohet neni 62(1) i Ligjit i Kodit Penal,

1 vetëm lejon gabimet ligjore në qoftë se i akuzuari për arsye
2 të justifikueshme nuk e dinte apo nuk mund ta dinte se ky akt
3 ishte i ndaluar.

4 Dhe provat nuk e mbështesin këtë. Dhe mund të shikoni
5 dosjen tonë ku -- dhe mund të shikoni provat ku ata janë në
6 video dhe diskutojnë paligjshmërinë e akteve. D.m.th. që nuk
7 ka asnjë bazë për të vendosur për gabim ligjor.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jam mirënjohës për këto.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
10 Gaynor.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Zoti Halling, do të filloj
12 me një pyetje në lidhje me paketën e dytë të dokumenteve.

13 Më herët kolegja juaj zonja Bolici, bëri një deklaratë që
14 më duket është pak në mospërputhje me dosjen tuaj.

15 Në faqen 15 të transkriptit, ajo tha që:

16 "Të gjitha faqet e nxjerra të paketave konfirmojnë në
17 pamje të parë se këto materiale përbëhen nga dokumente
18 konfidenciale të hetimeve apo analiza të brendshme të
19 materialeve hetuese dhe ishin shënuar si të tilla".

20 Në dosjen e ZPS-së, kur flisni për dëshminë e
21 dëshmitares Pumper ju thoni se:

22 "Ajo konfirmoi që Paketa 2 përmbante materiale publike të
23 gjykatave, përveç atyre 6 faqeve të korrespondencës
24 konfidenciale".

25 Desha t'ju pyes, nëse parashtrimet gojore që u bënë më

1 herët që, të gjitha faqet e nxjerra konfirmojnë në pamje të
2 parë e të tjerë?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Vetëm për të thënë se i kanë këto
4 karakteristika kur merren në tërësi. Paketa e dytë ka të bëj
5 vetëm me 6 faqe të dokumenteve të cilat janë publik, por
6 Paketa 2 në tërësi ka klasifikimin konfidencial për shkak të
7 këtyre faqeve.

8 Kjo është mënyra se përse ka ndodhur kështu. Janë 157
9 faqe të dosjes sonë përfundimtare. 156 faqe janë publike, një
10 faqe është konfidenciale dhe tërë dosja është konfidenciale.

11 Dhe prandaj themi ne që, e tërë paketa është e mbrojtur
12 për shkak të këtyre faqeve të cilat janë konfidenciale.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim]

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Më duhet të ngulmoj pak më
15 tutje. Për sa i përket materialeve publike të Gjykatës në
16 Paketën 2, a po thoni që për këto është kryer një vepër
17 penale?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

20 Tani ka të bëjë me standardin e synimit të drejtpërdrejtë
21 apo eventual, neni 21 i Kodit Penal. Gjykatësi Barthe pak më
22 parë ju pyeti lidhur me paragrafin 214 të dosjes përfundimtare
23 të ZPS-së. Dhe aty ju i kërkoni Trupit Gjykses që të miratojë
24 një standard të, në një farë mënyre, të të qenurit i
25 ndërgjegjshëm mbi sigurinë e plotë.

1 A e kuptoj nga përgjigja që i dhatë Gjykatësit Barthe që,
2 ju nuk po na kërkon që të aplikojmë këtë standard që po
3 kërkon thjeshtë Neni 21?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuari Gjykatës. 214 është
5 argumenti jonë. E vërteta është që standardi *mens rea*
6 pavarësisht si përkufizohet, është në thelb të parashtrimeve
7 tona. Ne flasim për këtë paragraf si një argument ku paraqesim
8 në dosjen tonë se cili është ligji, si duhet interpretuar. Dhe
9 është pikërisht ashtu siç e thatë dhe ju i nderuar Gjykatës.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po. Kalojmë tani në Paketën
11 e tretë.

12 Në paragrafin 257 ju thatë që:

13 "Aty kishte emra dhe pseudonime të dëshmitarëve të
14 identifikuar të cilëve u kishte dhënë masa mbrojtëse Gjykatat
15 e Kosovës, përfshirë edhe për identitetin e dëshmitarëve dhe
16 të procesverbaleve të tyre".

17 Ju më pas thatë që:

18 "Kjo Paketë e tretë ka referenca ndaj dëshmive të
19 dëshmitarëve dhe dokumente të tjera të paraqitur që i kanë
20 dhënë organizatat ndërkombëtare ZPS-së dhe entitete të tjera
21 të cilat janë të kufizuara dhe konfidenciale".

22 Trupi Gjykues nuk është në gjendje që t'i verifikojë këto
23 pohime vetë dhe pala Mbrojtëse nuk e ka bërë një gjë të tillë.
24 Kur them "Mbrojtje", e kam fjalën për avokatët Mbrojtës, nuk
25 kanë qenë në gjendje që të bëjnë pyetje lidhur me zgjedhjen që

1 ka bërë ZPS-ja për të mos i paraqitur këto si prova materiale
2 lidhur me provën 3. Por, zgjedhja që ka bërë ZPS-ja për të mos
3 e paraqitur Paketën 3 në procesverbal, i mohon palës Mbrojtëse
4 mundësinë për të bërë pyetje dhe për të kundërshtuar të gjitha
5 këto pohime që ka bërë vetë ZPS-ja.

6 Pra, dua të di se cili është qëndrimi juaj lidhur me
7 gjyqin e drejtë?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Do të thosha që, dëshmitë që kemi
9 paraqitur iu kanë krijuar mundësinë atyre për të bërë pyetje.
10 Për sa i përket pikës 4 [sipas përkthimit] i nderuar Gjykatës,
11 ju po përqendrohemi aty dhe kjo është me vlerë në këtë
12 drejtim.

13 ZPS-ja është një autoritet klasifikues dhe kjo mjafton
14 për t'i dhënë status mbrojtës dëshmitarit që është pjesë e
15 këtij procesi. Dhe nuk ka ndonjë kundërshtim të arsyeshëm që
16 të mund të çojë në këtë konkluzion, që ato duhet të
17 kontestojnë këtë pjesë të mbrojtur. A kanë mundësi që ta bëjnë
18 këtë për sa i përket vendimit të Gjykatës lidhur me materialet
19 që duhen nxjerrë apo nuk duhen nxjerrë. Pra, çdo gjë që është
20 pjesë e Paketës 3, ka qenë e mbrojtur.

21 Dhe ka disa dëshmi të tjera të cilët i keni përmendur ju
22 si pjesë e paragrafit 257, të nderur Gjykatës, por ne nuk kemi
23 argumentuar këtë që, një dëshmitar duhet të jetë i lidhur me
24 një urdhër të caktuar për masa mbrojtëse. Por po flasim
25 thjeshtë për mbrojtjen e të tërë dëshmisë së mbrojtur.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Unë nuk po e kundërshtoj
2 këtë, saktësinë e dëshmive të paraqitur nga ZPS-ja. Por unë po
3 kërkoj nga ju saktësi se si do të ishte në gjendje që ta
4 kundërshtonte këtë pala Mbrojtëse. Si mund, gjatë këtij gjyqi,
5 pala mbrojtëse t'i kundërshtonte pohimet e ZPS-së?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Praktikisht i nderuar Gjykatës,
7 kjo do të bëhej përmes kundër pyetjeve për zonjën Pumper.

8 Zoti Rees i bëri pyetje zonjës Pumper lidhur nëse ajo i
9 kishte parë nëse këto masa ishin aprovuar apo ishin hequr dhe
10 të gjitha këto mund të ishin nxjerrë gjatë gjithë kohës së
11 gjyqit.

12 Por për t'ju përgjigjur në përgjithësi, rregulla 140
13 paraqet dëshmi dhe më lejoni të citoj 140(4) ku thotë që:
14 Dëshmia e një dëshmitari të cilin i akuzuari nuk ka qenë në
15 gjendje t'i bëj pyetje, dëshminë e cila nuk i është nxjerrë
16 palës mbrojtëse.

17 Mund të themi që të gjitha këto situata nuk janë pjesë e
18 këtij argumenti, nuk ekziston një kërkesë e përgjithshme për
19 vërtetësim që do të duhet, apo ndonjë nxjerrje shtesë që do të
20 ishte e domosdoshme me qëllim që të shfrytëzohen si provë këto
21 dëshmi të paraqitura.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kalojmë tani në një fjalë që
23 del në paragrafin 257, ku flitet për disa lloje të
24 përgjegjësisë, ku thuhet që:

25 "Të njëjtat synime i kanë pasur".

1 Dhe ju paraqisni kategori njerëzish, përfshirë:

2 "...personat të cilët kanë marrë pjesë në mënyrë të
3 drejtpërdrejtë apo nga larg, apo që janë informuar përmes 3
4 konferencave për shtyp të të akuzuarve apo deklaratat e tyre
5 publike".

6 Çuditëse pse i keni përfshirë këto fjalë këtu. A mendon
7 ZPS-ja që personat të cilët kanë marrë pjesë, kanë mbikëqyrur
8 apo kanë informuar lidhur me këto 3 konferenca shtypi,
9 përmbajnë përgjegjësi penale?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës. Ky
11 paragraf është nga gjuha e aktakuzës dhe i referohet mënyrave
12 anësore të përgjegjësisë apo ndihmësive të përgjegjësive.

13 Ne po flasim për një grup njerëzish të cilët mund të
14 kishin kryer krime me të cilat janë ngarkuar të akuzuarit. Por
15 ne nuk po themi këtë që, thjesht prania në një konferencë
16 shtypi mund të jetë e barasvlershme me përgjegjësinë penale.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani dua të flasim për
18 konkluzionet alternative, për këndvështrimin e alternativave
19 të cilat i keni diskutuar në paragrafin 322 të dosjes suaj. Ju
20 i keni kërkuar Trupit Gjykoës që të dalë me konkluzion për të
21 gjitha mënyrat e përgjegjësive dhe për t'i hapur rrugën edhe
22 apelimit dhe për të ardhur me konkluzion lidhur me fajësinë
23 apo jo, mbi përgjegjësinë e të akuzuarve.

24 Pyetja ime nuk ka të bëjë me mënyrat e përgjegjësive, por
25 me synimin e drejtpërdrejtë apo eventual. Në qoftë se Paneli

1 është i bindur përtej dyshimit të arsyeshëm që provat tregojnë
2 se ka ekzistuar vërtetë një qëllim eventual dhe i
3 drejtpërdrejtë për një krim të caktuar, a duhet që Paneli të
4 gjejë fajtor për krimin e synimit eventual?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Është pyetje shumë interesante.

6 Ne do të kërkonim që të dilnit me konkluzion për këtë siç
7 kërkuam edhe për mënyrat e përgjegjësisë.

8 Arsyeya përse e quaj interesante pyetjen tuaj, se në
9 qoftë se ju bëni indeksimin e gjetjes fajtor me pikat e
10 Aktakuzës, gjetja fajtor për një pikë specifike duhet të
11 trajtohej veçmas.

12 Por, për shembull, në qoftë se gjeni fajtor për
13 frikësimin, atëherë nuk ka nevojë që të gjendet fajtor edhe
14 për synimin e drejtpërdrejtë apo eventual. Pra, i nderuar
15 Gjykatës, në qoftë se ju do ta kufizonit veten vetëm tek
16 synimi eventual apo i drejtpërdrejtë, ky do të ishte kufizim
17 të cilën ju mund ta bëni, por nuk do të mendoj që nuk do të
18 ishte i drejtë.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mbrojta e Gucatit në
20 paragrafin 142 të dosjes së tyre kanë thënë që, vendimi duhet
21 të tregojë në mënyrë të qartë përgjegjësinë penale të një të
22 akuzuari, që në fakt është një deklaratë mjaft e arsyeshme.

23 A mund t'ju pyes atëherë në qoftë se Paneli Gjykues nuk
24 duhet të dalë në konkluzion lidhur me synimin eventual apo të
25 drejtpërdrejtë?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Sipas mendimit tonë, mund të
2 konstatohet nëse ka pasur synim të drejtpërdrejtë apo jo.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ose njeri, ose tjetri?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se ju mendoni që njëra
5 anë apo tjetra është e rëndësishme, atëherë ajo duhet të ishte
6 e atillë me qëllim që të gjendet nëse personi i akuzuar është
7 fajtor apo jo.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pyetja e fundit ka të bëjë
9 me zinxhirin e ruajtjes që është në bazë të rregullit 39(4),
10 që thotë që:

11 "Prokurori i Specializuar duhet të përgatisë një inventar
12 dhe një shpjegim të hollësishëm të secilit material të
13 konfiskuar dhe përshkrimin e tij".

14 Në paragrafin 514 të dosjes së tyre, Mbrojtja e Haradinaj
15 thotë që nuk ekziston inventari. Në paragrafin 297 të dosjes
16 së tyre, Mbrojtja e Haradinaj citon dëshmitarin Robert Reid ku
17 thotë pjesërisht që, "nuk ka inventar" e vazhdon më tutje.

18 Unë mendoj, dhe më korrigjoni nëse e kam gabim, që Trupi
19 Gjykses nuk ka dëgjuar dëshmi që ZPS-ja të ketë përgatitur një
20 inventar dhe as që nuk ka përgatitur inventar. A është kështu?
21 E kam kuptuar si duhet?

22 Sidoqoftë, ne vërejmë që Rregullat e Procedurës dhe të
23 Provave i kërkojnë Prokurorit të Specializuar që të përgatisë
24 një inventar, por jo për ta paraqitur si provë materiale para
25 Trupit Gjykses. Desha t'ju pyes nëse jeni dakord me deklaratën

1 e Mbrojtjes së Haradinaj që nuk ka ekzistuar një inventar i
2 tillë. Në qoftë se nuk jeni dakord, shpjegoni përse. Shpjegoni
3 po ashtu se si përshtatet kjo me tërë argumentin që ka të bëjë
4 me zinxhir mbrojtës, ruajtës në përgjithësi.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Me sa di unë, inventari i
6 rregullës 39(4) kishte të bënte -- ka pasur thjesht [të bëjë]
7 me operacionin e kërkimit dhe të konfiskimit të 25 shtatorit.

8 Incidenti që ka çuar tek arrestimi i të akuzuarve nuk ka
9 pasur inventar që të përshtatej me rregullën 39(4) për sa i
10 përket faqeve të materialit dhe pranueshmërinë e tyre si
11 provë. Paket, të cilat janë paraqitur, janë pranuar si prova
12 materiale. Në qoftë se Mbrojtja e Haradinajt tani thotë që ky
13 është një dhunim i shkeljes së rregullës 39(4), atëherë ju
14 duhet ta drejtoni këtë argument të nderuar Gjykatës, pasi ne
15 themi që të gjitha faktet e inventarit kanë qenë të njohura në
16 kohën kur mund të ishte kundërshtuar një gjë e tillë.

17 Ndërsa prova që ka të bëjë me materialet e dërguara të
18 Paketave është e mbështetshme, ka vlerën e provës dhe është e
19 vërtetë dhe e drejtpërdrejtë. Dhe kjo është provuar gjatë
20 gjithë kësaj kohe kryesisht përmes dëshmitarit [e
21 pakuptueshme].

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mbrojtja e Haradinajt e
23 sulmon këtë nga një numër aspektesh, por më duket që në këtë
24 pikë ai e quan që është një shkelje e rëndë e ligjit apo
25 fatale.

1 A mund të shpjegoni që mungesa e inventarit nga ana e
2 Prokurorisë së Specializuar, pra mungesa e inventarit si provë
3 materiale nuk është fatale nga pikëpamja ligjore siç e
4 argumenton Mbrojtja e Haradinajt, për sa i përket zinxhirit
5 mbrojtës?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jo, nuk është
7 fatale. Mënyra si e kemi paraqitur ne dëshminë tonë, e ka
8 dëshmuar pikërisht këtë gjë gjatë gjithë kohës. Nuk ka
9 elementë të zinxhirit të ruajtjes të cilin duhet ta provonim
10 me inventarë specifike.

11 Ne na është dashur të provonim që faqet janë të vërteta
12 me qellim që ju t'i shikoni si prova materiale. Zinxhiri
13 mbrojtës apo i ruajtjes është vetëm një prej këtyre
14 elementëve, ku të akuzuarit flasin, nxjerrin faqe dhe këtë e
15 paraqesin në kamera dhe kur zonja Pumper konfirmon që këto
16 janë faqet në fjalë, edhe kjo ka vlerën e duhur për të
17 përcaktuar vërtetësinë për sa i përket Trupit Gjykses.

18 Mbrojtja e Haradinajt po kërkon të nxjerrë faktin që kjo
19 është një çështje e ndërlydhur, çështje zinxhir dhe nuk do të
20 ketë vlera autentike për sa i përket konkluzioneve tuaja.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Halling,
23 a mendon ZPS-ja se për sa i përket akuzës së frikësimit sipas
24 nenit 387 dhe aktakuzës numër 1, ekzistojnë provat e
25 drejtpërdrejta apo të tërthorta që kjo ishte një kanosje apo

1 kërcënim serioz?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po. Të dyja.
3 Ne ju kërkojmë të shikoni paragrafin 181 [sipas përkthimit] të
4 dosjes sonë. Është një teori e pengesës ku çështja e
5 kërcënimit të drejtpërdrejtë parashikohet nga shumë aspekte,
6 një nga të cilat është provat e drejtpërdrejta dhe identiteti
7 i atyre që kanë bashkëpunuar në këtë drejtim me TFHS dhe me
8 Prokurorinë. Dhe pikërisht është një nga rrethanat e
9 kontekstit të cilat e konfirmojnë seriozitetin e këtij
10 kërcënimi.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
12 të dhënat janë rrethanore si të thuash, dhe ne dalim me këtë
13 konkluzion, do t'ju pyesja lidhur me rregullën 140(3) që,
14 konkluzioni që mund të dalë nga dëshmitë e të akuzuarve është
15 që, këtu bëhet fjalë për një kërcënim të drejtpërdrejtë të
16 dëshmitarëve kur bëjnë këto deklaratat e të akuzuarit?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Për sa i përket provave
18 rrethanore, po, i nderuari Gjykatës. Ne folëm sot për
19 shembull, për një gabim shtypi për sa i përket akuzës së
20 shtytjes për një vepër penale. Kjo është një gjë e tillë.

21 Dhe ne do të thoshim që, sa herë që ka rrethana apo
22 dëshmi rrethanore, atëherë duhet që të trajtohet ajo në bazë
23 të parashikimeve apo dispozitave të Rregullores, i nderuar
24 Gjykatës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kaq kisha,

1 faleminderit.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kaq kishim
4 për sa i përket pyetjeve të ditës së sotme. Do të ritakohemi
5 nesër në orën 09.30.

6 Faleminderit Prokurorisë për ndershmërinë tuaj në
7 dëshminë mbyllëse, në deklaratën mbyllëse dhe në përgjigjet.
8 Dhe tani presim të shohim prezantimin e palës Mbrojtëse gjatë
9 ditës së nesërme në orën 9.30.

10 --- Seanca mbyllet në orën 14.59

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25